

# ISLAMI

## *Feja e Njerëzimit*

*Nga Maulana Muhamed Ali*

*me Parathënie nga*

Lord Headley

## *Përmbajtja*

*Shënim i Botuesit*

*Parathënie e Botimit Origjinal*

### **1. Hyrje**

Domethënia e emrit - Kuptimi i ri që ka marr në fe.

### **2. Disa Tipare Dalluese të Islamit**

Besimi në të gjithë profetët -

Persosmëria e fesë - Uniteti i njerëzimit - Një fe historike

### **3. Parimet Themelore të Islamit**

#### **4. Qenia Hyjnore**

Koncepti i Zotit në Islam - Ekzistenca e Zotit - Shembulli i Kuranit të Shenjtë - Uniteti (Njëshmria) e Zotit

#### **5. Shfaqja Hyjnore (Feksja Hyjnore)**

Besimi në profetët - Përsosmëria e shfaqjes - Vazhdimësia e formave më të ulta

#### **6. Jeta pas Vdekjes**

është vazhdim i kësaj jete - është shëmbëllim i gjendjes shpirtrore të kësaj jete - Përparimi i pakufishëm në jetën pas vdekjes

#### **7. Domethënia e Besimit**

Besimi në engjëjt - Besimi si bazë për veprim

#### **8. Parimet e veprimit**

#### **9. Detyrat e Njeriut ndaj Zotit**

Lutja - Agjërimi - Pelegrinazhi - Veprimet kuptimplote të adhurimit (lutjes)

#### **10. Detyrat e Njeriut ndaj Njeriut**

Vllazërimi i Islamit - Të drejtat e gruas - Shteti - Ilustrime të rregullit islamik - Xhihadi - Zeqati dhe Lëmosha

#### **11. Spektri i Mësimeve Morale**

### *Shënim i Botuesit*

"Islami - Feja e Njerëzimit" nga Maulana Muhamed Ali (vd. 1951) u botua për herë të parë më 1928 si një version i përmbledhur i Parathënies hyrëse të autorit në veprën e tij monumentale të vitit 1917 "Përkthimi Anglisht i Kuranit të Shenjtë, me Komente". Ky libërth popullor ka pasur ribotime të shumta në qindra mijë kopje, të cilat janë shpërndarë falas në të gjithë botën. Gjithashtu është përkthyer në shumë gjuhë përfshirë frëngjishten, gjermanishten, hollandishten, italishten, hungarishten, polonishten dhe kinezçen.

Duke parë popullariten që gëzoi ky libërth u ndje e nevojshme që të zgjerohej për të dhënë hollësira më të mëdha për mësimet fisnike të Islamit. Që nga botimi i tij fillestar, Maulana Muhamed Ali ka nxjerrë në drite libra të tillë të paçmuar e të vlerësuar lart si "Feja e Islamit" (1936), "Rendi i Ri Botëror" ((1944), "Mendime të Pavdekshme të Profetit të Shenjtë Muhamed" (1947), si dhe botimi i ripunuar i veprës së tij "Përkthimi i Kuranit të Shenjtë, me Komente" (1951). U ndje gjithashtu e nevojshme që shpalosja e pashëmbullit e Islamit që bëhej në këto libra të arrinte tek lexuesi edhe në trajtë shumë të përmbledhur.

Prandaj dhe "Islami – Feja e Njerëzimit" është zgjeruar duke përfshirë në të pasazhe të pershtatshem nga vepra e mësipërme madhore dhe nga librat e tjerë të Maulanas. Është ruajtur trajta origjinale e libërthit ndërkohë që janë zgjeruar kapitujt ekzistues dhe janë shtuar disa kapituj të rinj. Duke bërë këto shtesa u pa e nevojshme që të bëheshin disa redaktime të lehta për të garantuar vazhdimësinë e ekuilibrit brenda tekstit.

## *Parathënie e Botimit Origjinal*

nga Lord Headley<sup>1</sup>

Me kënaqësi shumë të madhe e kam lexuar epitomën e shkëlqyer të mësimit islamik të Maulana Muhamed Aliut dhe më ka bërë përshtypje të madhe zotësia që ka treguar ai për të përmbledhur, brënda hapësirës prej pak faqesh, të gjitha gjërat thelbësore të fesë sonë: thjeshtësia dhe sinqeriteti i veprës bëjnë që ajo të jetë një referencë e paçmueshme për të gjithë ata që seriozisht janë në kërkim të së vërtetës. Ndjehet qartë nevoja për një paraqitje të tillë konçize të Islamit, sepse, pavarësisht nga përparimet në fushën e arsimit dhe nga arsyetimi inteligjent rreth subjekteve fetare, është për të ardhur keq që ekziston ende në këtë vend një shkallë e konsiderueshme injorance rreth fesë muslimane.

Në një shkallë të konsiderueshme kjo ka të bëjë me paraqitjen e shtrembër që i kanë bërë asaj ata të cilët vërtet dijnë, por që me ligësi e fusin në rrugë të gabuar mendjen perëndimore në lidhje me fenë tonë. Disa nga gjykimet e gabuara që rrjedhin nga kjo praktike e pavlerë e paraqitjes se gabuar të gjërave janë: se muslimanët e adhurojnë Muhamedin si perëndi dhe i falën atij, se poligamia është pjesë e fesë islame, dhe se gratë nuk kanë shpirt. Sado e habitshme dhe e pabesueshme që mund të duket, unë jam i sigurtë se një numër shumë i madh njerëzish të respektuar e në drejtime të tjera mjaft të arsimuar në Angli vërtet besojnë se në e adhurojnë Muhamedin si perëndi, se jemi të detyruar të marrim shumë gra, dhe se gratë tona nuk kanë shpirt dhe nuk mund të shkojnë në Parajsë! Të gjitha këto ide janë krejtësisht të gabuara. Ne i falemi Allahut, te vetmit Zot që është vetëm një! "Vetëm Ty te falemi, dhe vetëm Ty të lutemi për përkrahje" - kjo është pjesë e lutjes së muslimanit dhe ne nuk bëjmë dallime midis profetëve të cilët janë zgjedhur nga I Plotfuqishmi në etapa të ndryshme të historisë së botës. Ka vetëm një Zot, dhe Muhamedi është Profeti, Profeti i Fundit, i Zotit. Poligamia ka qenë e përhapur në mënyrë të shfrenuar në tërë Arabinë përpara ardhjes së Muhamedit, i cili vetëm se vendosi rregull e kufizime duke përcaktuar numrin e grave që mund të marrë një burrë. Ai gjithashtu ndaloi krejtësisht zakonet e vrasjes së foshnjës femër të padëshirueshme që praktikohesh në Arabi përpara kohës së tij. Në kohën e sotme shumë pak muslimanë kanë më tepër se një grua, dhe pozita e gruas në botën muslimanë është shumë më e mirë se ç'është në vendet kristiane.

Shpresoj se do të ndërmerren hapa për ta përhapur gjërësisht këtë vepër të vogël, me që unë jam i bindur se një lexim i vëmendshëm i faqeve të saj do t'u sillte ndriçim e prehje atyre të cilët mund të mos jenë ende të vetëdijshëm për frymën e vërtetë të Islamit dhe që mund të jenë ende nën ndikimin e zhgënjimeve që u janë shkaktuar ose nga mungesa e informacionit të saktë, ose nga

---

<sup>1</sup>Lord Headley (vd. 1935) ishte një aristokrat britanik i cili e perqafoi Islamin me 1913 nën kujdesin e Khvaja Kamal-ud-Dinit, një nga misionarët e parë muslimanë në Evropë, i cili bënte pjesë Levizjen Lahore Ahmadijja. Lord Headley ishte i lidhur ngusht me Misionin Musliman të Uoking-ut në Angli, i cili u themelua nga Khvaja Kamal-ud-Din dhe drejtohej nga antarët e Ahmadijja Anxhuman Ishâ'at Islam, Lahore.

që kanë dëgjuar ata të cilët do të bënin mirë që të mos merreshin me paraqitjen e shtrembër të një feje simotër.

HEADLEY

## *Islami - Feja e Njerëzimit*

### 1. HYRJE

*Islam* është emri me të cilin njihet feja e predikuar nga Profeti i Shenjtë Muhamed, i cili u shfaq në Arabi më shumë se trembëdhjetë shekuj më parë,<sup>1</sup> dhe ajo është e fundit nga fetë e mëdha të botës. Kjo fe njihet rëndom në Perëndim si Muhamedanizëm, një emër që i është vënë në imitim të emrave të tillë si Kristianizëm e Budizëm, por që ishte krejt e panjohur për vetë muslimanët. Sipas Kuranit, Librit të shenjtë të Islamit, feja e Islamit është aq e gjërë në konceptimin e saj sa vetë njerëzimi. Ajo nuk u krijua thjeshtë nga predikimet e Profetit të Shenjtë Muhamed, por ka qenë fe e profetëve që kishin dalë përpara tij. Islami ishte feja e Adamit, Noas, Abrahamit, Moisiut dhe Jezusit; ajo ishte, në fakt, feja e çdo Profeti të Zotit, i cili u shfaq kudoqoftë, në çdo skaj të botës. Bile, Islami është dhe feja e çdo fëmije njerëzor që lind, sipas Profetit të Shenjtë, i cili, për të qenë të saktë, nuk është krijuesi por eksponenti më i fundit i atij sistemi Hyjnor i cili u përsos me ardhjen e tij. Dhe sipas Kuranit, Islami është feja e natyrshme e njeriut:

"Natyra e bërë nga Zoti në të cilën Ai ka krijuar njeriun – ajo është feja e drejtë" (30:30).

Dhe meqenë se, sipas Kuranit, profetët u ngritën midis popujve të ndryshëm në kohë të ndryshme, dhe se feja e çdo profeti, në pastërtinë e saj më të herëshme e të pandryshueshme, nuk ishte gjë tjetër veç Islam, spektri i kësaj feje, në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, shkon aq shumë mbrapa në shekujt e shkuar dhe është aq e gjërë sa vetë njerëzimi, ndërkohë që parimet themelore gjithmonë kanë mbetur njëjloj, ndërsa të papriturat kanë ndryshuar me ndryshimin e nevojave të njerëzimit. Faza e fundit e Islamit është ajo e cila u shfaq në botë me ardhjen e Profetit të Shenjtë Muhamed - paqja e bekimet e Zotit qofshin me të!

#### **Domethënia e emrit**

Emri *Islam* nuk u shpik, si në rastin e feve të tjera, nga ata që e shpallën si fe të tyre. Ky emer, nga ana tjetër, i është dhënë shprehimisht kësaj feje në Kuranin e Shenjtë. Ai thotë: "Unë (Zoti) e kam zgjedhur Islamin si fe për ju" (5:3). Dhe në një vend tjetër: "Sigurisht feja me Zotin është Islami" (3:18). Ai, për më tepër, është një emër domethënës; në fakt, fjala Islam tregon vetë esencën e sistemit fetar që njihet me atë emër. Domethënia e saj primare është "të bësh paqe", dhe idea e 'paqes' është idea sunduese në Islam. Sipas Kuranit të Shenjtë, musliman është ai që ka bërë paqe me Zotin dhe njeriun, si me Krijuesin ashtu dhe me krijesat e Tij. Paqja me Zotin nënkupton nënshtrimin e plotë ndaj vullnetit të Atij i cili është burimi i gjithë pastërtisë e mirësisë, kurse paqja

<sup>1</sup> Lindur me 571 C.E., vdekur me 632 C.E.

me njeriun nënkupton kryerjen e veprave të mira ndaj njeri-tjetrit. Të dyja këto ide gjenden të shprehura shkurt, por bukur, në 2:112, ku thuhet:

"Veç të tjerave, kushdo që i nënshtrohet plotësisht Zotit, dhe kryen vepra të mira ndaj të tjerëve merr shpërblimin e tij nga Zoti, dhe mos të ketë frikë për një gjë të tillë, dhe ata nuk do të brengosen."

Ky dhe vetëm ky është *shpëtimi* shpirtor sipas Kuranit të Shenjtë. Dhe duke qenë muslimani në paqe të përkryer, ai gëzon paqe të mendjes dhe kënaqsi shpirtore të plotë (16:106). "Paqe" është përshëndetja e muslimanëve për njeri-tjetrin, gjithashtu "Paqe" do të jetë dhe përshëndetja e atyre në parajsë: "Dhe përshëndetja e atyre atje lart do të jetë 'Paqe'" (10:10). Veç të tjerave, në parajsën që paraqet Islami asnjë fjalë tjetër nuk do të dëgjohet veç "Paqe, Paqe", siç thotë Kurani i Shenjtë: "Ata atje lart nuk do të dëgjojnë asnjë bisedë të kotë apo mëkatore, por vetëm thënien 'Paqe! Paqe!'" (56:25,26). "Autori i paqes dhe i sigurisë" është një ndajshtim për Zotin që përmendet në Kuranin e Shenjtë (59:23), dhe objektivi final drejt te cilit pikësynon Islami është "Banesa e Paqes", siç thuhet në 10:25: "Dhe Zoti fton në banesën e paqes". Paqja është, pra, esenca e Islamit, sepse ajo është rrënja nga del dhe fruti që jep, kështu që Islami është mbi të gjitha të tjerat *Feja e Paqes*.

### **Kuptimi i ri që i është dhënë fesë**

Në Islam koncepti i *fesë* merr një domethënie të re. Së pari, duhet të trajtohet jo si një dogëm, të cilën njeriu duhet ta pranojë në qoftë se dëshiron të shpëtojë nga dënimi i amshuem, por si një shkencë që mbështetet në përvojën universale të njerëzimit. Kështu, sipas Islamit, shfaqja Hyjnore (ose komunikimi i Zotit me njeriun) është një faktor i domosdoshëm në evoluimin e njeriut. Dhe që nga trajtat e saj më të thjeshta (siç janë ëndërat e vegjël e mirëfillta) e deri në format e saj më të larta (siç janë të vërtetat e ligjet fetare që i shfaqen profetëve të mëdhej të Zotit), shfaqje Hyjnore është pervoja universale e njerëzimit dhe një dhuratë Hyjnore që i është dhënë të gjithë popujve të botës.

Së dyti, duke përfunduar më tej idenë e shkencës në fe, Islami i paraqet të gjitha doktrinat e tij si parime të sjelljes e veprimit njerëzor, si dhe e bën çdo pikë të besimit si bazë për veprim nga ana e njeriut për zhvillimin e tij drejt shkalleve gjithnjë e më të larta të jetes.

Së treti, sfera e fesë nuk është e kufizuar vetëm brenda botës së përtejme; bile preokupimi i saj parësor është për këtë botë, që njeriu, duke bërë një jetë të respektueshme këtu në tokë, të mund të fitojë vetëdijen e një ekzistence më të lartë. Kështu pra, Kurani nuk merret vetëm me mjetet të cilat e bëjnë njeriun të jetë i lidhur me mish e me shpirt me Zotin, por dhe me problemet e botës rreth nesh, me çështjet e rëndësishme kuptimi i drejtë i të cilave i jep mundësi njeriut të bëjë një jetë të lumtur. Ai jep udhëzim për përparim individual, si dhe për ecjen përpara të shoqërisë, të kombit, bile dhe të njerëzimit. Ai e përgatit njeriun për një jetë tjetër, por vetëm pasi e ka bërë të aftë të jetë zot i vetes në këtë jetë.

## 2. DISA VEÇORI DALLUESE TË ISLAMIT

## Besimi në të gjithë profetët

Veçoria e madhe e Islamit është se ai kërkon që pasuesit e tij të besojnë që të gjitha fetë e mëdha të botës që kanë qënë të përhapura përpara tij janë shfaqur nga Zoti. Kësisoj, Islami hedh bazat e paqes dhe harmonise midis feve të botës. Sipas Kuranit të Shenjtë, nuk ka asnjë komb në botë në të cilin të mos jetë shfaqur një profet: "Nuk ka asnjë popull në gjirin e të cilit të mos ketë shkuar një paralajmëtar" (35:24). Më tej na thuhet se ka pasur profetë të tjerë përveç atyre që përmenden në Kuran: "Dhe Në të dërguam lajmëtarë që t'i kemi përmendur më parë, si dhe lajmëtarë të cilët Ne nuk t'i kemi përmendur" (4:164). Pra, Kurani jo vetëm parashtron teorinë se profetë janë shfaqur në të gjithë kombet, por shkon më tutje dhe e kërkon si domosdoshmëri që muslimanët të besojnë në të gjithë ata profetë (2:136, 177, 285). Gjithashtu, ndonëse besimi Islam përmbledhet në dy fjali të shkurtra, "*Nuk ka zot tjetër veç Allahut, dhe Muhamedi është Apostulli i Tij*", personi i cili e shpreh besimin në Muhamedin, duke e bërë këtë, ai pranon të gjithë profetët e botës, pavarësisht nëse emrat e tyre janë përmendur në Kuran ose jo. Kështu, Islami i del për zot një universalizmi për të cilin nuk mund të aspirojë asnjë fe tjetër, si dhe hedh bazat e një vëllazërimi gjithëpërfshirës sa vetë njerëzimi.

## Përsosja e fesë

Mirëpo misioni i madh i Islamit nuk ishte që të predikonte vetëm këtë të vërtetë, e cila, për shkak të izolimit nga njeri-tjetri të kombeve të ndryshëm të botës, nuk ishte predikuar më parë, por dhe të korigjonte gabimet të cilat kishin gjetur mënyrën për t'u futur ëe fe të ndryshme, të shoshiste të vërtetën nga gabimi, të predikonte të vërtetat të cilat nuk ishin predikuar më parë për shkak të rrethanave të veçanta të shoqërisë ose të etapave të herëshme të zhvillimit të saj, dhe, më e rëndësishmja e të gjithave, të bashkonte tok në një libër të vetëm të vërtetat që përmbante çdo shfaqje Hyjnore që i ishte dhuruar një populli për t'i treguar njeriut rrugën e drejtë; dhe në fund fare, të përmbushte të gjitha kërkesat morale e shpirtrore të një shoqërie njerëzore në përparim të vazhdueshëm. Kështu Islami pretendon me të drejtë se është shprehja përfundimtare dhe më e përsosur e vullnetit të Zotit, siç thotë Kurani:

"Në këtë ditë e kam përsosur Unë për ju fenë tuaj dhe e kam përmbushur mirësinë Time ndaj jush dhe kam zgjedhur për ju Islamin si fe" (5:3).

Gjithashtu, Kurani i Shenjtë përmendet si libër me "faqë të dlira, ku janë (të përfshirë të gjithë) librat e drejtë" (98:2,3), që do të thotë se të gjithë ato udhëzime të drejta që janë të nevojshme për ta udhëhequr njeriun në rrugë të drejtë, qofshin të shfaqura më parë ose jo, gjejnë shprehje të plotë në këtë Libër të Shenjtë.

## Uniteti i njerëzimit



Në përputhje me skemën Hyjnore, sipas së cilës profetët u shfaqën për rigjenerimin e botës, siç zbulohet në Kuran, çdo komb ka pasur profetët e vet. Pra, ndonëse dalja e profetëve ka qenë në një kuptim fakt universal, profetizmi ka qenë pak a shumë institucion kombëtar, ku spektri i mësimëve të një profeti kufizohej brenda kombit të vet. Prandaj hapi përfundimtar në institucionin e profetizmit ishte ardhja e një profeti për të gjithë kombet, kështu që idea madhështore e unifikimit të tërë racës njerëzore të mund të realizohej përsosmërisht. Misioni i Profetit të Shenjtë Muhamed përshkruhet kështu në Kuranin e Shenjtë: "I bekuar qoftë Zoti i Cili dërgoi poshtë *Furkanin* (Kuranin) tek shërbëtori i Tij që ai të jetë paralajmëtar për të gjithë kombet" (25:1); dhe "Thuaj: O njerëzim, sigurisht unë jam Lajmëtar i Zotit për ju të gjithë" (7:158). Prandaj Profeti Botëror zuri vendin e profetëve kombëtare, të gjitha pengesat gjeografike u fshinë si dhe të gjitha barrierat e ngjyrës e të racës, dhe mbi parimin e madh se "njerëzimi është një komb i vetëm" (2:213) u hodhën bazat e unitetit të racës njerëzore.

Duhet shtuar se një unitet i tillë i njerëzimit nuk mund të kryhej po të mos realizohej përfundimi i procesit të shfaqjes së profetëve, sepse në qoftë se do të vazhdonin të shfaqeshin profetë dhe pas daljes së Profetit Botëror, ata padyshim do t'u vinin kazmën themeleve të unitetit që synonte të realizonte Islami duke i dhënë të gjithë botës një profet të vetëm. Se këndejmi buron dhe thënia se Profeti i Shenjtë Muhamed është "Lajmëtar i Zotit dhe i fundmi i profetëve" (33:40). Mund të shtohet më tej se qëllimi i dërgimit të një profeti tek një popull ishte për të vënë në dukje rrugët që duhet të ndiqnin njerëzit për të vendosur lidhje të forta shpirtrore me Zotin. Ai qëllim arriti përsosmërinë nëpërmjet Profetit të madh Botëror, mesazhi i të cilit ishte aq i përsosur sa i përmbushte kërkesat jo vetëm për të gjithë kombet bashkëkohës por dhe për të gjithë brezat e ardhshëm. Kjo pretendohet qartë nga Kurani (shih 5:3 të cituar më lart), një pretendim që nuk parashtrohet nga ndonjë fe tjetër. Meqenë se feja kështu arriti përsosmërinë, nuk mbeti nevojë për ndonjë fe tjetër pas Islamit apo për ndonjë profet tjetër pas Profetit Muhamed.

## Një fe historike

Dëshiroj të vë në dukje dhe një veçori tjetër të Islamit nëpërmjet kësaj hyrjeje. Nuk ka asnjë dyshim se Islami është një fe historike dhe Themeluesi i saj i Shenjtë një personazh historik. Është një fakt që edhe një kritik armiqësor i Islamit është i detyruar ta pranojë. Çdo ngjarje në jetën e Profetit të Shenjtë mund të lexohet në dritën e historisë. Gjithashtu, Kurani i Shenjtë, i cili është burimi i të gjitha ligjeve shoqërore e shpirtrore të Islamit, siç është nënvizuar nga Bosworth Smith<sup>1</sup>, është "një libër absolutisht i pashembullt në origjinën e tij, në ruajtjen e tij . . . në autenticitetin thelbësor të të cilit askush nuk ka qenë në gjendje ndonjëherë të hedhë ndonjë dyshim serioz." Bile dhe Muiri<sup>2</sup> e pranon se "ndoshta nuk ka vepër tjetër në botë që të ketë ruajtur për dymbëdhjetë shekuj një tekst kaq të pastër", dhe shton me Von Hammer-in se "ne kemi mendimin se Kurani është fjala e Muhamedit po me atë shkallë sigurie që muhamedanët besojnë se ajo është fjala e Zotit."

<sup>1</sup> Autor i librit "*Muhamedi dhe Muhamedanizmi*" (Londër, 1889)

<sup>2</sup> Sir William Muir, autor i librit "*Jeta e Muhamedit*" dhe i librave të tjerë mbi Islamin, dhe një kritik armiqësor i Islamit, i cili jetoi në shekullin e 19-të.



Duke pasur një libër të shfaqjes Hyjnore të ruajtur në mënyrë kaq të sigurtë gjatë shekujve si udhërrëfyes drejt mirëqenies së tij shpirtore e morale, si dhe duke pasur shembullin e një Profeti kaq të madh e fisnik, përvojat e larmishme të të cilit në jetë ofrojnë rregullat më të mira të sjelljes në të gjitha etapat e ndryshme të jetës njerëzore, muslimani është i sigurtë se nuk ka hedhur poshtë asnjë të vërtetë që i është zbuluar ndonjëherë nga Zoti ndonjë kombi, dhe se ai nuk ka mohuar (barazuar me zero) asnjë të mirë që mund të gjëndet në jetën e një njeriu të mirë. Kësisoj muslimani jo vetëm beson në të vërtetën e të gjitha shfaqjeve Hyjnore dhe i pranon udhëheqësit e shenjtë të të gjithë popujve, por dhe i ndjek të vërtetat e përhershme e të qëndrueshme që gjenden në ato shfaqje Hyjnore duke pranuar e zbatuar më të fundit e më kuptimplotet prej tyre, si dhe i imiton të gjithë njerëzit e mirë në gjithshka të mirë që kanë në jetën e tyre duke marrë si model elzemplarin më të përkryer.

### 3. PARIMET THEMELORE TË ISLAMIT

Parimet kryesore të Islamit jepen në fillim fare të Kuranit të Shenjtë, i cili hapet me fjalet:

"Ky Libër, i cili nuk ka asnjë dyshim në të, është një udhërrëfyes për ata të cilët janë të devotshëm në kryerjen e detyrave të tyre, të cilët besojnë në Atë që nuk shihet dhe e vazhdojnë pa ndërprerje lutjen dhe shpenzojnë (me zemërgjërësi) nga ajo që Ne u kemi dhënë atyre, dhe të cilët besojnë në atë që të është shfaqur ty (O Muhamed) dhe në atë që u shfaq përpara teje, dhe që janë të bindur për Botën e përtejme" (2:2-4).

Keto vargje vëne në dukje parimet esenciale të cilat duhet të pranohen nga ata të cilët do të ndiqnin Kuranin e Shenjtë. Keto kemi tri pika kryesore të besimit dhe dy pika kryesore të praktikës, ose tri porosi teorike dhe dy praktike. Përpara se t'i marr keto pika një nga një, mendoj se është e domosdoshme të ve në dukje, siç tregohet në keto vargje, se në Islam vetëm besimi nuk vlen asgjë në qofte se nuk zbatohet në praktike. "Ata që besojnë dhe bëjnë të mira" është pershkrimi i perseritur i të drejteve sipas Kuranit. Besimi i drejtë është fara e mirë e cila mund të rritet e të bëhet veç peme e mirë në qofte se merr ushqim nga toka ku është mbjelle. Ai ushqim jepet me vepra të mira. Një pikë tjetër e domosdoshme për t'u mbajtur parasysh në lidhje me pesë parimet e besimit e praktikës të permendura në vargjet e cituara më lart është se ato, në një formë apo në një tjetër, janë pranuar në mënyrë universale nga raca njerëzore.

Pesë parimet siç i kemi treguar tashme janë: (1) besim në Zotin, në të Padukshmin e Madh, (2) besim në shfaqjen Hyjnore; (3) besim në jetën e përtejme; kurse nga ana praktike: (4) lutje Zotit, i cili është burimi nga i cili del dashuria e Zotit, dhe (5) lemosha në kuptimin më të gjërë - të gjitha keto tregojnë respektivisht kryerjen e detyrave tona ndaj Zotit dhe njeriut. Tani, keto pesë parime të besimit e të veprimtimit janë pranuar nga të gjithë kombet e rruzullit tokësor. Keto janë parimet e perbashketa mbi të cilat mbështeten të gjitha fetet. Në fakt, keto pesë parime themelore të feseve të shenjta të Islamit janë të ngulitura në natyrën njerëzore. Keto une do t'i marr një nga një, ashtu siç janë pershkruar me hollësi në Kuranin e Shenjtë.

### 4. QENIA HYJNORE

## Konceptimi i Zotit ne Islam

Nga tre parimet themelore te besimit, i pari eshte besimi ne Zotin. Besimi ne nje fuqi me te larte se njeriu mund ta gjejme duke shkuar mbrapa deri ne antikitetin me te larget, ne kohrat me te hereshme ne te cilat mund ta na çoje historia, por popuj te ndryshem ne epoka te ndryshme e ne vende te ndryshme kane pasur koncepte te ndryshme mbi Qenien Hyjnore. Islami, pike se pari, predikon nje nje Zot, i Cili qendron mbi te gjithë hyjnite fisnore dhe perendite kombetare. Zoti i Islamit nuk eshte Zoti i nje kombi te veçante, i Cili do t'i kufizonte bekimet e Tij vetem per ate komb, por Ai pershkruhet ne fjalet hyrese te Kuranit te Shenjte se eshte “Zoti i te gjitha botrave” (1:1), keshtu qe, perveç se jep konceptimin me te larte te Qenies Hyjnore, ai edhe e zmadhon rrethin e vllazerimit te njeriut ne menyre qe te perfshihen te gjithë kombet e botes, duke e zgjeruar keshtu botekuptimin e simpatite e njeriut.

Midis attributeve(cilesive) te shumta sublime te Qenies Hyjnore te cilave u jep shprehje Kurani i Shenjte, atributi i meshires eshte ne krye te vendit. Pikerisht me fjalet *al-Rahman* dhe *al-Rahim* hapet çdo kapitull i Librit te Shenjte. Fjalet *Bamires* e *Meshirues* i zbulojne lexuesit te Kuranit te Shenjte vetem nje ide teper te manget e te ceket te dashurise e meshires se thelle e gjithëperfishirese te Zotit te shprehur me fjalet *al-Rahman* dhe *al-Rahim*. “Meshira Ime perfshin te gjitha gjerat, “ thuhet ne Kuranin e Shenjte (7:56). Rrjedhimisht Lajmetari (I Derguari) i cili predikoi kete koncept te Qenies Hyjnore me te drejte cilesohet ne Kuranin e Shenjte si “meshire e te gjithë kombeve” (21:107). Po ashtu, Zoti eshte Autori (Krijuesi) i gjithëshkaje qe ekziston. Mohimi i fuqise se Tij krijuese do t'i kishte dhene goditje vdekjprurese pikerisht madheshtise e sublimitetit te konceptit te Qenies Hyjnore. Ja vetem nje pershkrim i attributeve te Tij:

“Ai eshte Allahu perveç te Cilit nuk ka Zot tjetër, i Gjithdituri per gjithëshka qe nuk shihet dhe qe shihet. Ai eshte Bamiresi, Meshiruesi. Ai eshte Allahu perveç te Cilit nuk ka Zot tjetër, Mbreti, Shenjtori, Autori i paqes, Siguri-dhenesi, Mbikqyresi i gjithëshkaje, I Plotfuqishmi, Supremi, Poseduesi i madheshtise. I lartesuara qofte Allahu mbi gjithëshka qe krijuan ata (si zoter te rreme)! Ai eshte Allahu, Krijuesi, Ndertuesi,<sup>1</sup> Forme-dhenesi: Te Tijet jane emrat me te bukur. Gjithëshka qe eshte ne qiell e ne toke e deklarone lavdine e Tij; dhe Ai eshte i Fuqishmi, i Urti” (59:22-24).

Zoti qendron mbi te gjitha kufizimet, dhe Ai nuk mund te ngjasohet me asgje te njohur nga njeriu (42:11). Ndersa Zoti kupton çdo vegim, vegimi i njeriut nuk mund ta perfshije Ate (6:104). Ai eshte Nje; dualiteti ose triniteti ne natyren Hyjnore, apo shumefishimi i perendive as qe mund te mendohet (2:163; 16:51; 4:171); ai nuk mban asnje lidhje atesie apo biresimi me asnje (112:3; 19:90-93). Ai eshte I Gjithëshkadituri (20:7), I Plotfuqishmi (16:48-50), dhe I Kudogjenduri (58:7), duke qene njekohesisht me afer njeriut se vetja e tij (50:16; 56:85). Ka nje numer shume te madh attributesh tjera per Qenien Hyjnore te cilat e lartesojne konceptin e Zotit ne Kuran te pakrahasueshem me asnje liber tjetër te shfaqur.

<sup>1</sup> Fjala origjinale per *Ndertues*, *Beres* eshte *Bari* qe para se gjithash do te thote *Ndertues*, *Krijues* i shpirtrave ne dallim nga *Krijuesi* i materies.

## Ekzistenca e Zotit

Duke qene se besimi ne Zotin eshte themeli i Islamit, ne te parashtrihen tre lloje argumentesh qe lidhen me ekzistencen e Zotit:

1. Universi material jep deshmi se duhet te kete nje Krijues e Kontrollues te universit. Ne Kuranin e Shenjte kjo deshmi perqendrohet rreth fjales *Rabb*, atributi i pare i Qenies Hyjnore per te cilin terheq vemendjen Shfaqja hyjnore – “Lexo ne emer te *Rabb-it* tend” (96:1) – dhe me te cilin fillon Kurani i Shenjte (1:1), duke qene njekohesisht dhe atributi i perseritur me shpesh ne Librin e Shenjte. *Rabb*, zakonisht e perkthyer si *Zot i boteve* per ta dhene shkurt, do te thote *Kujdestar prindror i nje gjeje ne menyre te atille qe ta beje ate te pervetesoje gjendje zhvillimi te njepasnjeshme derisa te arrije qellimin e vet te persosmerise*. Gjithshka e krijuar ne kete menyre mban stampen e krijimit Hyjnor ne vecorine e levizjes se vazhdueshme perpara nga etapat me te ulta ne ato me te larta derisa arrin plotesine. Evolucioni, i cili ka provuar se eshte nje bllok pengues per fete tjera, behet kesisoj ne Islam pikerisht baza e besimit ne Zotin, si dhe sherben si argument i qellimit dhe i urtesise ne krijim. Njeshmeria (harmonia) e ligjit qe mbizoteron ne univers, pavaresisht nga shumllojshmeria e jashtezakonshme qe ka ai (67:3,4), ekzistenca e kontrollit e ligjeshmerise me te rrepte ne te gjitha Natyren qe nga pjesezat me te vogla deri ne sferat me te fuqishme (36:38; 55:5,6), si dhe argumente te tjera te ngjashme ndeshen ne cdo faqe te Librit te Shenjte.
2. Grupi i dyte i argumenteve per ekzistencen e Zotit ka te beje me shpirtin njerezor ne te cilin eshte rrenjosur, sipas Kuranit te Shenjte, vetedija e ekzistences Hyjnore. Ne qenien e mbrendshme te njerezve behet vazhdimisht pyetja: “Kot jane krijuar ata, nga hiçi?”, “A mos jane ata krijuesit e shpirtit te tyre?”, “A mos i krijuan ata qiejt e token?” (52:35,36), “A nuk jam Une *Rabb-i* juaj?” (7:172). Keshtu pra tregohet se vetedija e ekzistences se Zotit eshte pjese perberese dhe e pandashme e natyres njerezore. Nganjehere kjo vetedije permendet duke paraqitur nje afersi te paimagjinueshme te shpirtit njerezor me Shpirtin Hyjnor: “Ne jemi me afer njeriut se damari i qafes se tij” (50:16); “Ne jemi me afer shpirtit tuaj se vete ju” (56:85). Me anen e kesaj tregohet vetedija e ekzistences se Zotit ne shpirtin e njeriut eshte bile dhe me e qarte se vetedija e vete ekzistences se tij. Natyrisht kjo vetedije ndryshon ne natyra te ndryshme ne varesi nga drita e brendshme e njeriut, sa e ndritshme apo e zbehte eshte ajo.

Ky argument forcohet me tej duke treguar se ka diçka me teper sesa vetedija e thjeshte e ekzistences se Zotit. Fryma e Zotit eshte thithur nga njeriu duke i dhene jete atij (15:29), prandaj dhe shpirti i njeriut eshte i perkushtuar ndaj Zotit; ne te eshte i rrenjosur instinkti per t'i sherbyer Zotit dhe per t'iu drejtuar Atij per ndihme (1:4). Cdo njeri, bile dhe politeisti ai qe beson ne shume perendi, i drejtohet Zotit ne vuajtje fizike e ne deshperim, kur shfaqet me ngulm forca e plote e natyres njerezore (10:12,22; 39:8). Keshtu ngulitet me tej besimi te Zoti, me anen e te cilit ai udhehiqet ne ertesire e veshtiresi ((10:9); ngulitet dashuria e Zotit, nga e cila buron gatishmeria per t'i ofruar sherbim vetmohues njerezimit (2:177; 76:8); ngulitet besueshmeria ne Zotin, e cila eshte nje burim i sigurte force per njeriun ne kohe te veshtira (14:12).

3. Porse deshmia me e qarte dhe me e sigurte e ekzistences se Zotit jepet nga pervoja shpirtrore, me larte e njerezimit, nga shfaqje e Zotit Vete perpara njeriut. Deshmia e mençurise dhe qellimit ne univers vetem sa tregon se *duhet* te kete nje Zot, por nuk te shpie ne ndonje bindje te sigurte se Zoti *eshte*; deshmia e vehtes se brendshme te njeriut eshte gjithashtu e pamjaftueshme per te na çuar drejt kesaj bindjeje te sigurte dhe per t'i dhene mundesi njeriut qe te ballafaqohet me Qenien Hyjnore. Eshte shfaqja Hyjnore ajo qe jo vetem ben realitet aspiraten me te larte te kesaj jete se Zoti *eshte*, por dhe hedh nje lume drite mbi atributet Hyjnore dhe e nxjerr njeriun ne rruge ne te cilen, duke ecur ne te, ai e ndjen ekzistencen e Tij si nje realitet ne vete jeten e tij dhe e cila i jep mundesi atij qe te mbaje lidhje te ngushta shpirtrore me Ate. Eshte pikerisht ky kuptim i Qenies Hyjnore qe sjell nje ndryshim ne jeten e njeriut dhe i jep atij nje force shpirtrore te parezistueshme me anen e se ciles ai mund te sjelle ndryshime bile dhe ne jeten e te tjereve. Shfaqja e Zotit Vete perpara njeriut eshte, sipas Islamit, pervoja universale e njerezimit, pervoja e njerezve ne te gjitha kombet, te gjitha vendet dhe te gjitha epokat. Eshte kjo pervoje shpirtrore universale e njerezimit qe ka provuar se eshte nje force e rendesise se dores se pare qe sherben per ta ngritur njerezimin nga thellesite e degjenerimit drejt majave me te larta te moralit dhe bile te prosperitetit material.

### Shembulli i Kuranit të Shenjtë

Kurani i Shenjtë jep shembullin më të madh të ekzistencës dhe veprës së Zotit që tregohet nga shfaqja Hyjnore. Ajo zbulon të vërteta e parime sublime të cilat nuk mund të ishin produkt i dijes njerëzore të një arabi të pashkolluar që jetoi në shekullin e shtatë, siç ishte Profeti i Shenjtë Muhamed. Ai sollti një transformim të pakrahasueshëm në historinë e botës. Në jo më shumë se njëzet-e-tre vjet (609-632 C.E.) u krye një transformim i plotë në jetën e tërë kombit që banonte në Gadishullin Arabik, një tokë ku shekuj punë reformuese të mëparëshme kishin qenë të pafrutshme. Adhurimi i idhujve i rrënjosur thellë u zëvendësua nga adhurimi i një Zoti; të gjitha supersticionet u fshinë dhe në vend të tyre doli feja më e racionale që mund të merrte me mend bota; njerëzit që krenoheshin me injorancën e tyre u bënë përkrashtit më të flaktë të dijes, duke u zhytur thellë e duke pirë në çdo burim të dijes që ata mund të gjenin; shtypja e të dobtëve, të varfërve, skllëvërve e grave i lëshoi vendin drejtësisë e barazisë; dhe një komb i zhytur në veset më të thella u pastrua tërësisht nga ato dhe u pajis me një dëshirë të zjarrtë për veprat më fisnike në shërbim të njerezimit. Kurani përmbushi një transformim jo vetëm të individit, por po aq dhe të familjes, të shoqërisë, të një kombi të tërë, dhe, nëpërmjet atij kombi, të vetë njerezimit. Nuk ka libër tjetër që të ketë sjellë një ndryshim kaq të mrekullishëm në jetën e njerezve, duke i ngritur ata nga thellësitë e degjenerimit në kulmet më të larta të qytetërimit.

Kurani i Shenjtë jo vetëm realizoi këtë transformim madhështor, por që në fillim të karrierës së Profetit të Shenjtë ai paralajmëroi profeci të njëpasnjëshme, duke dhënë siguri të plota e të padiskutueshme, që do të vërtetonin se kundërshtimi i pamëshirshëm do të shuhej dhe do të triumfonte Islami. Këto profeci u shpallën në kohën kur Profeti i Shenjtë ishte fare vetëm dhe i pashpresë, i mbuluar nga të gjitha anët nga kundërshtime të egra, dhe nuk ekzistonte as rrezja më e vogël e shpresës që Islami të bënte ndonjë përparim. Megjithatë ato u përmbushën vetëm pak vjet më vonë në mënyrën më të habitshme. Asnjë njeri nuk mund të kishte parashikuar atë që u

profetizua aq qartë se do të ndodhte me siguri, dhe asnjë fuqi njerëzore nuk do të kishte mundur t'i shkaktonte disfatë të plotë një kombi të tërë të rreshtuar kundër një njeriu të vetëm. Shfaqja Hyjnore kësaj jep provën më të qartë e më të sigurtë të ekzistencës së Zotit, dituria e pafund e të Cilit kupton të ardhshmen si dhe të shkuarën e të tashmen, dhe i Cili kontrollon si forcat e natyrës ashtu dhe fatin e njeriut.

### Uniteti (Njëshmëria) e Zotit

Uniteti i Zotit është tema e madhe numër një e Kuranit të Shenjtë. Shprehja me e njohur e kësaj është ajo që përmbahet në deklaratën e *lā ilāha ill-Allāh* (“nuk ka zot tjetër përveç Allahut”), e cila zbulon domethënien se nuk ka asgjë që meriton të adhurohet përveç Allahut. Unitet i Zotit do të thotë, së pari, se nuk as pluralitet perendishë as pluralitet personash në rolin e Zotit; se dyti, nuk asnjë qenie që të zotërojë ndonjë atribut Hyjnor në përsosmëri; dhe së treti, askush nuk është në gjendje të bëjë atë që ka bërë Zoti, ose që mund të bëjë Zoti.

E kundërta e Unitetit është *shirk*-u (të shoqëruarit e ‘zotave’ me Zotin, apo njohja e cilësive Hyjnore të tjerët dhe jo te Zoti), e cila thuhet se është më e rënda e të gjitha mëkateve (31:13) për faktin se kjo e demoralizon njeriun, ndërsa Uniteti Hyjnor sjell ngritjen e tij morale. Format e larmishme të *shirk*-ut të përmendura në Kuran përfshijnë: adhurimin e gjërave të tilla si idhujt, kafshët, forcat e natyrës, etj., duke kujtuar se sende e qenie të tjera mbartin në vetvete të njejtattribute si Zoti, si në doktrinën e trinitetit apo në idenë e bashkë-përjetësisë së materies e shpirtit, duke ndjekur verbërisht komandat e urdhërat e njerëzve të mëdhenj dhe duke iu nënshtruar verbërisht dëshirave të dikujt. Këto tregojnë se në doktrinën e Unitetit Kuran i jep botës një mesazh fisnikëruës të përparimit të gjithanshëm, si fizik ashtu dhe moral e shpirtor. Njeriu çlirohet jo vetëm nga skllavëria ndaj objekteve të gjalla e jo të gjalla, por dhe nga idhujtaria ndaj forcave të mrekullishme të natyrës, të cilat, siç i thuhet në Kuran, ai mund t'i nënshtrojë për dobinë e tij (45:12,13). Ai shkon më tutje dhe e çliron njeriun nga më e madhja skllavëri e të gjitha skllavërive – skllavëria e njeriut nga njeriu. Ai nuk i lejon asnjë të vdekshmi dinjitetin e të qenit Zot, apo e të qenit më tepër se një i vdekshëm; kurse më i madhi i të vdekshëmve (Profeti i Shenjtë) është i urdhëruar të thotë: “Unë jam vetëm një i vdekshëm si të gjithë ju; mua më është shfaqur që Zoti juaj është vetë Një Zot (18:110). Kështu u këputen të gjitha prangat që e mbanin të skllavëruar mendjen e njeriut, dhe ai u vu në rrugën e përparimit.

## 5. Shfaqja Hyjnore

Parimi i dytë themelor i besimit në fenë Islame është besimi në shfaqjen Hyjnore, jo vetëm besim në vërtetësinë e Fjalës së shfaqur të Zotit siç gjëndet në Kuranin e Shenjtë, por besim në vërtetësinë e shfaqjes Hyjnore në të gjitha epokat dhe në të gjithë kombet e botës. Disa fe e konsiderojnë shfaqjen sikur i është dhënë njerëzimit vetëm një herë; të tjere e shikojnë atë si të kufizuar brenda një populli të caktuar; kurse disa të tjerë e mbyllin portën e shfaqjes Hyjnore pas njëfarë kohe. Me ardhjen e Islamit ne gjejmë të njejtën gjërësi pikëpamjeje që jepet si për konceptin e shfaqjes Hyjnore ashtu dhe për konceptin e Qenies Hyjnore.



Sipas Kuranit të Shenjtë, shfaqja në format e saj më të ulta, në trajtën e frymëzimit apo në atë të ëndërave e vegimeve, është përvojë universale e njerëzimit. Në mënyrë të ngjashme, në formën e saj më të lartë, në atë të shkrimeve e ligjeve të shfaqura në mënyrë Hyjnore, ajo nuk kufizohet brenda një njeriu të veçantë apo një kombi të veçantë por është një e drejtë që e gëzon çdo komb pa dallim. Pa mbështetjen e shfaqjes nga Zoti, asnjë popull nuk do të kishte mundur të realizonte bashkimin shpirtor me Zotin, dhe si rrjedhim që e nevojshme që Zoti i Plotfuqishëm, i Cili, duke qënë i Gjithpushtetshëm i tërë botës, i pajisi të gjithë njerëzit me nevojat e tyre fizike, duke u sjellë atyre njëkohësisht edhe bekimet e Tij shpirtore. Kështu idea e shfaqjes Hyjnore në Islam është aq e gjërë sa vetë njerëzimi, dhe muslimanit i kërkohet të besojë jo vetëm në Kuran, por në të gjithë Librat e Zotit që i janë dhene të gjithë kombeve të botës.

### **Besimi në Profetët**

Me që shfaqja e Librit të Zotit duhet të transmetohet nëpërmjet një njeriu, besimi në lajmëtarin është një rrjedhojë e natyrshme dhe përmendet në Kuran tok me besimin në librat e shfaqur. Profeti nuk është vetëm bartës i mesazhit Hyjnor, por ai tregon gjithashtu se si duhet interpretuar ai mesazh në jetën praktike; prandaj ai është modeli që duhet ndjekur. Është pikërisht shembulli i tij që i mbush me besim të gjallë zemrat e pasuesve të tij dhe sjell një transformim real në jetën e tyre. Së këtejmi del se ka një domethënie më të thellë që nënvizon besimin në profetët. Siç është thënë më parë (shih nënkapitullin 2), besimi në të gjithë profetët e botës është parim themelor i fesë islame. Kurani i Shenjtë e ka të shprehur qartë se në të gjithë kombet dolën profetë dhe se nuk i ka përmendur të gjithë, gjë që në fakt është e panevojshme. Prandaj muslimani mund të pranojë se mendjendriturit e mëdhenj të kohrave të shkuara që respektohen nga cilido komb tjetër i kanë sjellë atij kombi dritë e drejtim, si profetët e kombit të tij.

### **Përsosmëria e Shfaqjes Hyjnore**

Sipas mësimave të Islamit, shfaqja nuk është vetëm universale por progresive, duke arritur përsosmërinë në të fundmin e Profetëve, Profetin e Shenjtë Muhamed. Shfaqjet iu dhuruan çdo kombi në përputhje me kërkesat e tij, dhe në çdo epokë shfaqja u realizua në përputhje me kapacitetin e popullit të asaj epoke. Dhe nësa truri i njeriut po bëhej gjithnjë e më i zhvilluar, gjithnjë e më shumë dritë u hodh nga shfaqja mbi çështje të tilla si ekzistenca dhe atributet e Zotit, natyra e shfaqjes nga Ai, kompensimi për të mirën dhe të keqen, jeta pas vdekjes, etj. Kurani, libri i shenjtë i shfaqur i fundit, hedh dritë të plotë mbi të gjitha gjërat thelbësore të fesë, bën të qarta ato që, për shkak të rrethanave, kishin mbetur të errëta, dhe e bëri fenë të përsosur.

Përveç kësaj, Kurani vë në dukje se mësimet e librave të shenjtë të mëparshëm kishin pësuar ndryshime, dhe prandaj vetëm një shfaqje nga Zoti mund t'i veçonte mësimet e pastërta Hyjnore nga masa e gabimeve që ishin grumbulluar rreth tyre. Këtë bëri Kurani, prandaj dhe quhet "kujdestar" i të gjithë librave të shenjtë të mëparshëm. Ai gjithashtu merr përsipër edhe rolin e gjykatësit, duke përcaktuar dhe ndryshimet midis tyre. Të gjitha fetë kanë ardhur nga Zoti, mirëpo edhe doktrinën e tyre bazë kanë pësuar ndryshime nga njera tjetra deri në atë shkallë sa që është bërë thjesht e pakonceptueshme që ato të kenë dalë nga i njëjti burim Hyjnor. Më në fund që Kurani ai që vuri në dukje terrenin e përbashkët, me fjalë të tjera, Unitetin e Zotit dhe universalitetin e shfaqjes.



### Vazhdimësia e formave më të ulta të shfaqjes

Islami jo vetëm e quan shfaqjen Hyjnore si përvojë universale të njerëzimit, por dhe e konsideron portën e saj si përherë të hapur për të gjitha kohrat. Ndonëse shfaqja arriti përsosmërinë dhe profetizmi u mbyll me personin e Profetit të Shenjtë MuhamedZoti vazhdon t’u flasë të zgjedhurve të tij ndërmjet muslimanëve. Shfaqja në format e saj më të ulëta – në formën e ëndrave, vegimeve e frymëzimeve të vërteta – është diçka që u ndodh si profetëve ashtu dhe atyre që nuk janë profetë.<sup>1</sup> Eshtë vetëm shfaqja autoritare, forma e shfaqjes së veçantë te profetët, ajo që ka përfunduar pas Profetit të Shenjtë Muhamed. Dëshmohej se ai është shprehur kështu: “Asgjë nuk mbetet nga profetizmi përveç *mubashshirât-it*”; dhe kur e pyetën se çfarë do të thoshte *mubashshirât*, ai u përgjigj: “Vegim i vërtetë”. Në një Shprehje tjetër të tij na thuhet:

“Midis kombeve përpara jush kishte persona me të cilët kishte folur Zoti ndonëse ata nuk ishin profetë; në qoftë se ka një të tillë ne gjirin e popullit tim ai është Umari.”

Kjo tregon se, ndonëse nuk do të ketë profetë pas Profetit të Shenjtë Muhamed, me qenë se feja dhe ligjet fetare kishin arritur përsosmërinë me ardhjen e tij, shfaqja Hyjnore është një fakt edhe sot e kësaj dite dhe për një musliman të vërtetë ekziston mundësia ta provojë. Bindja reale se Zoti ekziston realizohet pikërisht nëpërmjet fjalës së Tij; gjithashtu, një besim vital në Zotin rivendoset pikërisht nëpërmjet të përzgjedhurve të cilët bëhen dëshmitarë të shfaqjes së Tij.

Eshtë dhe një aspekt tjetër i besimit islamik në shfaqjen Hyjnore i cili është i ndryshëm nga ai i disa feve të tjera të botës. Ai nuk pranon të njohë mishërimin e Qenies Hyjnore. Eshtë një fakt i njohur universalisht që qëllimi më i lartë i fesë është bashkimi shpirtor me Zotin. Sipas Kuranit të Shenjtë, ky bashkim shpirtor nuk realizohet duke marrë Zoti trajtë njerëzore në kuptimin e mishërimit, por duke e ngritur njeriun gradualisht drejt Zotit me anë të përparimit shpirtor dhe pastrimit të jetës së tij nga të gjitha dëshirat sensuale dhe motivet e ulëta. Qenia e përsosur që i zbulon botës fytyrën e Zotit nuk është Qenia Hyjnore në trajtë njerëzore, por ajo qenie njerëzore personi i të cilit është bërë një manifestim i attributeve Hyjnore duke e lënë personalitetin e tij që të shkrihet në zjarrin e dashurisë për Zotin. Shembulli i tij shërben si stimul dhe është model për t’u ndjekur nga të tjerët. Ai tregon nëpërmjet shembullit të tij se si një i vdekshëm mund të arrijë bashkimin shpirtor me Zotin. Së këndejmi buron parimi i gjërë i Islamit se askush nuk pengohet për t’u ushqyer nga burimi i shfaqjes Hyjnore, dhe se kushdo mund ta arrijë atë duke ndjekur Fjalën e Shenjtë të Zotit siç shfaqet në Kuranin e Shenjtë.

## 6. JETA PAS VDEKJES

Besimi në një jetë të ardhme, në një formë apo në një tjetër, është gjithashtu e përbashkët për të gjitha fetë e botës, dhe është neni i tretë themelor i besimit të muslimanit. Mirëpo misteri i jetës pas vdekjes askund nuk është zgjidhur aq qartë sa në Islam. Idea e jetës pas vdekjes ka qënë aq e errët

<sup>1</sup> Shih Kuranin, 28:7, 5:111, etj.

deri vonë, deri në kohën e daljes së fesë çifute, sa që jo vetëm se nuk gjëndet shumë për këtë e shprehur në Testamentin e Vjetër, por një sekt i rëndësishëm çifut në fakt e mohonte fare ekzistencën e një gjëndjeje të tillë. Megjithate, kjo lidhet me faktin se në shfaqjet më të hershme nuk ishte hedhur shumë dritë mbi këtë. Besimi në ‘transmigracion’ (apo rimishërim i shpirtrove) kishte të bënte dhe me mendjen e pazhvilluar të njeriut që realitetet shpirtrove gabimisht i merrte për fakte fizike. Në Islam, idea e jetës së përtejme arriti përsosmërinë e saj, siç ndodhi dhe me parime të tjera të rëndësishme e themelore të fesë. Besimi në një jetë të ardhshme nënkupton dhënien llogari të njeriut në një jetë tjetër për veprimet e bëra në këtë jetë. Besimi padyshim është një bazë shumë e vyer për ngritjen morale të botës në qoftë se kuptohet si duhet. Pikat e mëposhtëme theksohen në mënyrë të veçantë nga Kurani i Shenjtë.

### **Jeta pas vdekjes është vetëm një vazhdim i jetës këtu poshtë**

Hendeku që përgjithësisht vihet ndërmjet kësaj jete dhe jetës pas vdekjes është pengesa më e madhe në zgjidhjen e misterit të jetës së përtejme. Islami bën që të zhduket fare ky hendek: ai bën që jeta e ardhshme të konsiderohet thjesht si vazhdim i jetës së tanishme. Për këtë pikë Kurani i Shenjtë shprehet fare qartë. Aty thuhet:

“Ne kemi bërë (pikërisht në këtë jetë) që pasojat e veprave të njeriut t’i ngjiten atij për qafe, dhe këto pasoja të fshehta Ne do t’i nxjerrim në shesh në Ditën e Ringjalljes në formën e një libri krejt të hapur” (17:13,14).

Dhe përsëri aty thuhet:

“Kushdo që është i verbër në këtë jetë, do të jetë i verbër edhe në botën e përtejme; po, dhe do të largohet gjithnjë e më shumë nga rruga e drejtë” (17:72).

Kurse në një vend tjetër kemi:

“O shpirt që je në prehje! Kthehu tek Zoti yt, se Ai është i kënaqur me ty dhe ti je i kënaqur me Atë. Pra hyr midis shërbyesve të Mi dhe hyr në Kopështin Tim” (89:27-30).

E para e këyre citimeve e bën të qartë se faktet e mëdha që do të dalin në dritë ditën e Gjykimit nuk do të jenë diçka e re, por vetëm një manifestim i asaj që është fshehur këtu nga syri fizik. Prandaj jeta pas vdekjes nuk është një jetë e re, por vetëm një vazhdim i kësaj jete që nxjerr në dritë realitetet e saj të fshehura. Dy citimet tjera tregojnë se një jetë qiellore apo një jetë skëterre – të dyja fillojnë në këtë botë. Verbëria e jetës së ardhshme është skëterrë, por sipas vargjeve të cituara vetëm ata që janë të verbër këtu do të jenë të verbër dhe në jetën e përtejme, duke e bërë të qartë se verbëria shpirtrove e kësaj jete është skëterra e vërtetë, dhe që këtë ajo merret me vete në botën tjetër. Po ashtu, është pikërisht shpirti që ka gjetur paqe e prehje të përsosur ai që griset për të hyrë në parajsë pas vdekjes, duke treguar kështu se parajsa e botës tjetër është vetëm një vazhdim i paqes e prehjes që njeriu gëzon shpirtirisht në këtë jetë. Kështu, është e qartë se, sipas Kuranit të Shenjtë, jeta e përtejme është një vazhdim i kësaj jete, dhe vdekja nuk është një ndërprerje por një hallkë lidhëse, një derë që hap realitetet e fshehura të kësaj jete.

### **Jeta pas vdekjes është një shembëllim i gjendjes shpirtore në këtë jetë**

Me Islamin është hedhur dritë e plotë mbi të vërtetën më kuptimplote përsa i përket jetës së përtejme. Në mësimet kristiane truporja dhe shpirtorja shkrihen bashkë; për të qarat e vajtimet e kërcitjet e dhëmbëve dhe zjarrin e pashuar si ndëshkim për të liqtë flitet me të njejtën shtrirje si për mbretërinë e qiellit, thesaret e qiellit dhe jetën e përhershme si shpërblim për të drejtët; mirëpo nuk jepen tregues të qartë të burimeve të njerës apo të tjetrës. Nga ana tjetër, Kurani i Shenjtë e bën të qartë se gjendja pas vdekjes është një përfaqësim i plotë, një shembëllim i qartë e i plotë, i gjendjes sonë shpirtore në këtë jetë. Këtu kushtet e mira ose të këqia të veprave ose besimeve të një njeriu janë latente (të pranishme por të padukshme) brenda tij; helmi apo ballsami i tyre lëshojnë ndikimin e vet mbi të vetëm në mënyrë të fshehtë, por në jetën e ardhshme ato do të bëhen të dukshme e të qarta si drita e diellit. Trajta që marrin veprat tona e pasojat e tyre në këtë jetë nuk është e kapshme nga syri i njeriut në këtë jetë, por në jetën e përtejme ajo do të shpaloset në tërë qartësinë e saj. Prandaj dhe kënaqësitë e vuajtjet në jetën e ardhshme, ndonëse shpirtore në realitet, nuk do t'i fshihen syrit të zakonshëm siç ndodh me faktet shpirtore në këtë jetë. Është për këtë arsye që ndërsa, nga njëra anë, huret e të mirat e jetës së përtejme përmenden me emra fizikë si dëshmi e shfaqjes së tyre të qartë përpara syve, nga ana tjetër ato përmenden si gjëra të cilat “syri nuk i ka parë, as veshi nuk i ka dëgjuar, as nuk ka arritur dot zemra e njeriut që t’i ndjejë a t’i provojë”. Ky përshkrim i hireve e bekimeve të jetës së ardhshme është vërtet një shpjegim i dhënë nga vetë Profeti i Shenjtë për vargun e Kuranit ku thuhet se askush nuk i di huret e gëzimet të cilat i janë mbajtur të fshehta (32:17).

Vargjet e mëposhtme të Kuranit të Shenjtë, të cilat rëndom mund të keqkuptohen, nuk i përshkruajnë fare huret e kënaqësitë qiellore si të njëllajta me gjërat e kësaj bote. Në to thuhet:

“Dhe jepi lajme të gëzuara atyre që besojnë e bëjnë vepra të lavdërueshme, se për ta janë kopështet nëpër të cilët rrjedhin lumenj. Sa herë që u jepet një sasi me fruta prej andej, ata do të thonë: ‘Ja nga këto na janë dhënë neve më parë,’ dhe atyre u jepen gjëra të ngjashme me ato” (2:25).

Tani frutat për të cilat të drejtët do të thonë se i kanë shijuar në këtë jetë nuk është e mundur që të jenë frutat e pemëve ose gjërat e kësaj jete. Këto vargje, në fakt, na thonë se ata që besojnë e bëjnë vepra të mira përgatisin një parajsë për vete me duart e tyre, ku frute do të jenë veprat e tyre të mira. Pikërisht nga frutet e këtij kopështi ata do të shijojnë shpirtërisht këtu, si dhe nga të njëjtat, vetëm se në një trajtë më të kapshme e të qartë, do të hanë ata në jetën tjetër. Mund të citojmë dhe një varg tjetër që vazhdon të njejtën ide: “Atë ditë ju do të shihni burrat e devotshëm dhe gratë e devotshme, me dritën që shkëlqen përpara tyre në krahun e tyre të djathtë” (57:12). Ky varg tregon se drita e besimit nga e cila ishin udhëhequr në këtë jetë burrat e gratë e drejtë e të moralshëm, dhe e cila mund të shihej këtu vetëm me syrin shpirtor, do të shihet qartë duke ndriçuar përpara besimtarëve në ditën e Ringjalljes.

Si në rastin e hirësive e kënaqësive të parajsës, edhe ndëshkimi i ferrit është një shembëllim i torturave shpirtore të kësaj jete. Ferri thuhet se është një vend ku njeriu as nuk do të jetojë, as nuk do të vdesë (20:74).

Duhet të kujtojmë në lidhje me këtë se Kurani i përshkruan ata që bien në gabime e ligësi si të vdekur e pajetë, kurse të mirët i quan të gjallë. Sekretet e kësaj është se mjetet e jetës së atyre që e lënë

pas dore Zotin, duke u dhënë vetëm pas të ngrënit e të pirit dhe kënaqjes së dëshirave të tyre fizike, do t'u ndërpriten me vdekjen e tyre. Ata nuk kanë pjesë në ushqimin shpirtor, prandaj dhe, duke iu mohuar jeta e vërtetë, ata do të ngrihen përsëri për të shijuar pasojat e këqia të veprave të tyre të liga.

### **Përparimi i pakufishëm në jetën pas vdekjes**

Islami na mëson se njeriu është i destinuar të bëjë përparime të pakufishme në jetën pas vdekjes. Ai që e nënvizon këtë është parimi se zhvillimi i aftësive të njeriut siç ndodhë në këtë jetë nuk quhet i mbyllur me kaq, por një horizont shumë më i gjërë zhvillimi shpallet përpara tij pas vdekjes. Ferri ka për qëllim vetëm ta pastrojë njeriun nga 'skorjet', mbeturinat e padobishme, që ka grumbulluar me duart e veta, me qëllim që ta bëjë të përshtatshëm për përparim shpirtor në atë jetë. Vargjet 106 e 107 të kapitullit 11 të Kuranit tregojnë qartë se ndëshkimi i ferrit nuk është i përhershëm. Ka gjithashtu Thënie të Profetit të Shenjtë dhe të Shokëve të tij të cilat nuk lënë pikë dyshimi se ferri është një vend i përkohshëm për mëkatarin, qoftë musliman apo jo-musliman, dhe se ndëshkimi i rreptë i ferrit është një ilaç për të shëruar sëmundjet e tij shpirtore dhe për t'i dhënë mundësi atij që të hyjë sërish në rrugën drejt një jete më të lartë. As parajsja nuk është një vend për kënaqësi të rëndomta; ajo në thelb është një vend për t'u ngjitur në nivele gjithnjë e më të larta (39:20). Për ata që janë në parajsë thuhet se kanë një dëshirë të pashuar për të arritur shkallë gjithnjë e më të larta përsosmërie; prandaj dhe lutja e tyre është: "Zoti ynë, bëje të përsosur për ne dritën tonë" (66:8).

## 7. DOMETHENIA E BESIMIT

### **Besimi në engjëjt dhe domethënia e tij**

Tani unë kam treguar shkurt tre parimet themelore të besimit të një muslimani, por mund të shtoj më tej se besimi në "atë që nuk shihet" përfshin dhe një besim në ata ndihmësa që ne i quajmë engjëj. Ky besim, ndonëse i përbashkët për shumë fe, nuk pranohet aq gjërësisht sa tre parimet e shpjeguara më lart, prandaj dhe nuk do të jenë pa vend këtu disa vërejtje që kanë të bëjnë me të vërtetën që qëndron prapa këtij besimi. Në botën fizike e gjejmë si ligj të pranuar se ne kemi gjithnjë nevojë për agjentë (shtytës) të jashtëm, pavarësisht nga aftësitë e forcat brënda nesh. Syri na është dhënë për të parë gjërat, dhe ai i sheh ato por jo pa ndihmën e dritës së jashtme. Veshi kap tingujt, por në mënyrë të pavarur nga agjenti i ajrit ai nuk mund të shërbejë për atë qëllim. Prandaj njeriu në thelb ka nevojë për diçka përveç asaj që është brenda tij, dhe kjo qëndron si për botën fizike ashtu dhe për atë shpirtore.

Pikërisht ashtu siç nuk janë të mjaftueshme vetëm aftësitë tona fizike për të na dhënë mundësinë që të arrijmë një objekt të çfardoshëm në botën fizike pa ndihmën e agjentëve të tjerë, ashtu dhe forcat tona shpirtore nuk mundën që ato vetëm të na udhëheqin drejt veprave të mira ose të këqia. Me fjalë të tjera, ka dy forca tërheqëse që veprojnë në natyrën njerëzore: tërheqja drejt të mirës apo ajo që të shtyn për t'u ngritur në sfera më të larta të virtytit, dhe tërheqja drejt të ligës, apo ajo që të shtyn të ulësh poshtë e më poshtë në një lloj jete të ulët, shtazarake. Mirëpo për t'i vënë në lëvizje këto dy forca tërheqëse nevojiten agjentë të jashtëm, ashtu siç nevojiten në rastin e forcave fizike te njeriut.

Ai shtytës që e vë në veprim forcën tërheqëse drejt të mirës quhet *engjëll*, kurse ai që ndihmon në funksionimin e forcës tërheqëse drejt të ligës quhet *djall*. Në qoftë se i përgjigemi tërheqjes për të bërë mirë, ne i shkojmë pas Shpirtit të Shenjtë, kurse në qoftë se i përgjigemi tërheqjes për ligësi, ne i shkojmë pas Satanit. Prandaj domethënia reale e besimit në engjëjt është se ne duhet ndjekim atë që na grish drejt të mirës ose forcës tërheqëse për të bërë mirë e cila gjëndet brenda nesh.

### Besimi si bazë për veprim

Vërejtjet e mësipërme shpjegojnë jo vetëm domethënien e besimit të muslimanit në engjëjt, por dhe kuptimin që qëndron prapa vetë fjalës *besim*. Besimi, sipas Islamit, nuk është vetëm bindje në të vërtetën e një çështjeje të dhënë, por është në thelb pranimi i një çështjeje si bazë për veprim. Siç është treguar tashmë, çështja e ekzistencës së djajve është po aq e vërtetë sa ajo e ekzistencës së engjëjve; mirëpo ndërsa besimi në engjëjt përmendet vazhdimisht si pjesë e besimit të muslimanit, neve asgjekundi nuk na kërkohet të besojmë në djajtë. Të dy faktet janë njëlloj të vërtetë, dhe Kurani i Shenjtë bën fjalë në shumë raste për insinuatat e përpjekjet e djajve për t'i futur njerëzit në rrugë të gabuar, por ndërsa kërkohet që t'u zëmë besë engjëjve, ai nuk kërkohet besim në djajt. Në qoftë se besimi në engjëjt do të ishte vetëm një ekuivalent për pranimin e ekzistencës së tyre, edhe besimi në djajt do të ishte domosdoshmëri e njëllojtë. Mirëpo nuk është kështu. Arsyeja është se ndërsa njeriut i kërkohet të pranojë e të ndjekë thirrjen e atij që të grish drejt të mirës, atij nuk i kërkohet që të ndjekë thirrjen e atij që të grish për të bërë keq. Prandaj dhe ne besojmë në engjëjt por nuk besojmë në djajt, me qenë se të parët japin bazë për veprim, kurse të dytët jo. Nga ana tjetër, Kurani i Shenjtë kërkohet *mosbesim* ndaj djajve: “Kështu, kushdo që nuk u zë besë djajve dhe beson në Zotin, ai vërtet kapet pas lidhjes më të fortë” (2:256).

Kështu pra mund të shihet se parimet e besimit të numëruara më sipër, ashtu siç jepen në Kuranin e Shenjtë, janë me të vërtetë parime që secila prej tyre shërben si bazë për veprim, dhe asnjë besim tjetër nuk njihet nga Islami. Fjala *Allāh* – fjala arabisht për Zotin – tregon atë Qenie e Cila i ka të gjitha atributet e përsosura, dhe kur muslimanit i kërkohet të besojë në Allahun, atij vërtet i kërkohet që ta bëjë veten posedues të të gjitha atyre attributeve të përsosmërisë. Besimi në shfaqjen Hyjnore e bën atë të pranojë e të imitojë gjithshka të mirë që ndeshet në jetën e njerëzve të devotshëm, dhe besimi në jetën e përtejme është ekuivalent i njohjes së parimit të llogari-dhënies për veprimet e kryera.

## 8. PARIMET E VEPRIMIT

Tani le të marrim anën praktike të besimit Islam. Siç e kam përmendur më lart, në Islam veprimet janë në thelb pjesë përbërëse e fesë si besim. Në këtë drejtim Islami zë një vend të mesëm midis feve të cilat e kanë lënë krejt pas dore anën praktike dhe atyre që i lidhin pasuesit e tyre pas rrituleve për çdo minutë. Ai e sheh domosdoshmërinë e zhvillimit të aftësive mendore të njeriut duke i dhënë udhëzime të përgjithshme, pastaj i lë dorë të lirë individit për të vënë në zbatim atë që është e arsyeshme për të.

Pa një karakter praktik të fortë cilado fe ka të ngjarë të bjerë në idealizëm të thjeshtë dhe nuk do të



ushtrojë më ndikim në jetën praktike të njeriut. Rregullat morale të Islamit, të cilat ngulmojnë në përvetësimin e detyrave ndaj Zotit dhe të detyrave ndaj njeriut, bazohen në atë njohje të thellë të natyrës njerëzore të cilën nuk mund ta zotërojë askush tjetër përveç Autorit (Krijuesit) të asaj natyre. Ato përfshijnë tërë gamën e zhvillimit të njeriut, dhe i janë përshtatur kështu në mënyrë të mrekullueshme kërkesave të popujve të ndryshëm. Në Kuranin e Shenjtë gjenden rregulla udhërrëfyese si për njeriun e rëndomtë të botës, ashtu dhe për filozofin, dhe si për bashkësitë njerëzore që janë në shkallë më të ulta të qytetërimit, ashtu dhe për kombet më të zhvilluara të botës. Praktikabiliteti është kyçi i rregullave morale të tij, kështu që po ai universalitet i cili karakterizon parimet e tij të besimit ndeshet dhe në urdhëresat e tij praktike, duke iu përshtatur kësaj të gjitha epokave dhe të gjitha kombeve.

## 9. DETYRAT E NJERIUT NDAJ ZOTIT

### Lutja

Vargjet e Kuranit të Shenjtë të cituara më lart (Shih nënkaptullin 3) formojnë, siç kam thënë tashmë, bërthamën e mësimëve të Islamit. Të marrë në kuptimin më të gjërë të fjalës, dy parimet e veprimit të përmendur në këto vargje kanë të bëjnë me përmbushjen e detyrave të njeriut ndaj Zotit dhe të detyrave të tij ndaj njeriut.<sup>1</sup> Të luturit Zotit është thelbi i detyrave të njeriut ndaj Zotit. Lutja është një zbrazje e ndjenjave të zemrës, një kërkesë e përvuajtur, e sinqertë dhe e devotshme ndaj Zotit, si dhe një shprehje plot respekt e dëshirave më të sinqerta të shpirtit përpara Krijuesit të tij. Në Islam idea e lutjes, si të gjitha idetë tjera fetare, gjen zhvillimin e vet më të lartë. Lutja, sipas Kuranit të Shenjtë, është mjeti i vërtetë i atij pastrimi të zemrës i cili përbën rrugën e vetme të komunikimit shpirtor me Zotin. Kurani i Shenjtë thotë:

“Recitoje atë që të është shfaqur nga Libri dhe lutu (falu) vazhdimisht. Është më se e vërtetë që lutja (falja) e mban njeriun larg të padenjës dhe të ligës; dhe sigurisht të kujtuarit e Zotit është më e madhja (forcë)” (29:45)

Prandaj Islami poroset me ngulm që të bëhet lutja (falja) si mjet i ngritjes morale të njeriut. Lutja që degjeneron në një ritual të thjeshtë, në një ceremoni të thatë e bajate që kryhet me mungesë sinqeriteti në zemër, nuk është lutja që rekomandohet si detyrë nga Islami. Një lutje e tillë demaskohet shprehimisht: “Mjerë ata që luten, të cilët janë të shkujdesur ndaj lutjeve të tyre! Dhe ata që sikur bëjnë mirë vetëm për t’u dukur” (107:4-6). Në të njëjtin paragraf thuhet gjithashtu se lutja është e padobishme në qoftë se nuk të drejton nga shërbimi ndaj njerëzimit.

Në Islam nuk ka Sabbath apo ditë të caktuar për lutje. Lutja është bërë pjesë e punëve të përditshme të njeriut. Është veprimi i parë i ditës së një muslimani, është gjithashtu dhe veprimi i tij i fundit, kurse ndërmjet këtyre dy lutjeve ka dhe tri lutje të tjera gjatë orëve të punës ose të shlodhjes. Pra Islami kërkon që, edhe kur është në kulm të punës, një musliman duhet të jetë në gjendje të shkëputet nga të gjitha angazhimet materiale për një kohë të shkurtër dhe t’i kushtohet lutjes. Si rrjedhojë Islami i ka eliminuar të gjitha institucionet e murgjërësive, të cilat kërkojnë që njeriu të heqë

<sup>1</sup> “. . . ata të cilët . . . luten vazhdimisht dhe shpërndajnë (për të ndihmuar nevojtarët) nga ato që u kemi dhënë Ne atyre”.



dorë nga të gjitha angazhimet materiale gjatë tërë jetës së tij me qëllim që mbajë komunikimin shpirtor me Zotin. Islami e bën të mundur komunikimin shpirtor me Zotin edhe kur njeriu është i zënë në kulm me angazhimet e tij materiale, duke bërë kështu të mundur atë që konsiderohej e pamundur përpara ardhjes së tij.

Mënyra islamike e adhurimit (faljes) është llogaritur për të përqëndruar vëmendjen mbi një objekt: realizimin e pranisë Hyjnore. Abdesi që paraprin lutjet, pozicioni i respektuar gjatë qëndrimit në këmbë, përkulja përpara, rënia përmbys dhe pozicioni i respektuar në gjunjë – të gjitha ndihmojnë mendjen për ta realizuar praninë Hyjnore si fakt; dhe njeriut që falet i mbushet zemra me ngazëllim kur ia bën nderet Zotit të Madh jo vetëm me gojë por dhe me tërë trupin.

Në Islam, faljet e përditshme kolektive (në grup) janë gjithashtu mjete të nivelimit të të gjitha dallimeve të rangut, ngjyrës e kombësisë, si dhe mjete që sjellin kohezion e unitet midis njerëzve gjë që përbën bazën e domosdoshme të qëndrueshmërisë së një qytetërimi. Përpara Krijuesit të tyre, të gjithë besimtarët qëndrojnë sup më sup, sundimtari bashkë më shtetasin më të përvuajtur, të pasurit me lypsin, i bardhi me zezakun. Për më tepër, mbreti apo i pasuri në një rradhë mbrapa është i detyruar ta vërë kokën, kur bie përmbys përpara Zotit, tek këmbët e të varfërit që është përpara. Dallimet e rangut, pasurisë e ngjyrës zhduken brenda xhamisë, dhe brenda mureve të saj mbizotëron një atmosferë vllazërimi, barazie e dashurie. Në fakt, pesë faljet e përditshme kanë për qëllim, përveç të tjerave, të zbatojnë në praktikë mësimet teorike të barazisë e vllazërimit që ka në themel Islami.

Por ndërsa Islami i ka dhënë status të përhershëm institucionit të lutjes duke kërkuar që të respektohet në kohë të caktuara dhe në një mënyrë të caktuar, ai ka lënë gjithashtu hapësirë të gjërë për vetë individin, veçanërisht në pjesën e lutjes kur ai falet vetëm, që të bëjë çfaredo lutjesh që dëshiron dhe në cilëndo gjuhë që i pëlqen, në njërin nga katër pozicionet (më këmbë, i përkulur përpara, i rënë përmbys, ose i ulur).

### Agjërimi

Agjërimi është një nga ato institucione fetare të cilat, ndonëse të njohura botërisht, janë pasuruar nga Islami gjersa kanë marrë një kuptim krejt të ri. Islami e mohoi krejtësisht idenë se agjërimi shërben për të qetësuar zemërimin Hyjnor, ose për të ngjallur keqardhjen Hyjnore me anën e vuajtjes së vullnetshme, dhe në vend të saj futi agjërimin e rregullt si disiplinë shpirtrore, morale e fizike e shkallës më të lartë. Objekti i këtij institucioni është i shprehur qartë në Kuranin e Shenjtë: “Agjërimi rekomandohet si detyrim për ju . . . që ju të ruheni nga e keqja” (2:183).

Për këtë qëllim Islami ka vënë në dispozicion muajin e *Ramadaan*-it. Çdo ditë në këtë muaj, kërkohet që të mos hamë e të mos pijmë e të mos bëjmë marrëdhënie seksuale nga agimi deri në perëndim të diellit. Por agjërim do të thotë dhe që të frenohemi nga çdo lloj ligësie. Në fakt, mosngrënia e ushqimit është vetëm një hap për ta bërë njeriun të kuptojë se në qoftë se ai mundet që, si bindje ndaj Zotit, ta privojë veten nga diçka që është përndryshe e ligjshme, atëherë sa herë më e rëndësishme është që ai ta frenojë veten nga kryerja e veprimeve të liga të cilat janë të ndaluara nga Zoti!

Nuk ka tundim më të madh se tundimi për të shuar etjen e urinë kur ke përpara ushqime e pije; megjithatë, ky tundim kapërcehet nga agjëruesi, jo një herë a dy herë, si të ishte rastësisht, por çdo

ditë rregullisht për një muaj të tërë, me një qëllim të përcaktuar për t'u afruar gjithnjë e më shumë tek Zoti. Kurdoherë që i del përpara një tundim, ai e kapërcen atë sepse është një zë i brendshëm që i thotë: “Zoti është me mua”, “Zoti më shikon”; kështu prania Hyjnore bëhet një realitet për të dhe brenda tij zgjohet një vetëdije e re e një jete më të lartë – një jetë mbi atë që mbahet me anën e të ngrënit e të pirit – dhe kjo është jeta shpirtore.

### Pelegrinazhi (Haxhi)

Pelegrinazhi (haxhilleku) në Mekë, i cili qëndron si detyrë për t'u kryer nga çdo musliman një herë gjatë jetës së tij në qoftë se ai i ka mjetet financiare, përfaqëson fazën e fundit në përparimin e shtegtarit shpirtor. Ai përfaqëson fazën në të cilën njeriu i dorëzohet plotësisht vullnetit të Zotit, si dhe sakrifikon të gjitha interesat e tij dhe i flak tutje të gjitha komoditetet e tij të jetës për hir të dashurisë së Zotit. Kërkesa e parë e Pelegrinazhit, e njohur si *Ihrām*, në të cilën hiqen të gjitha veshjet e kushteshme dhe shtegtari shpirtor ka vetëm dy çarçafë pa tegela për të mbuluar trupin, përfaqëson këputjen e të gjitha lidhjeve materiale për hir të dashurisë së Zotit. Një tipar tjetër i spikatur i Pelegrinazhit është *Taëāf*-i, rrotullimi rreth Qabesë (Ka`ba)<sup>1</sup>, dhe duke kryer këtë akt të jashtëm shtegtari tregon se zjarri i dashurisë Hyjnore është ndezur brenda zemrës së tij, dhe si një që ka rënë vërtet në dashuri, ai bën rrotullime rretheqark Shtëpisë së Atij që dashuron. Në fakt, e gjithë gjendja e shtegtarit dhe të gjitha devocionet e ndryshme të lidhura me Pelegrinazhin përfaqësojnë shkallën në të cilën adhuruesi, i brumosur me dashurinë e vërtetë për Qenien Hyjnore, tregon se i është dorëzuar plotësisht Zotit të tij të dashur dhe i ka flijuar të gjitha interesat e veta për hir të Tij.

Në zhvillimin vjetor të Pelegrinazhit, ka një grumbullim të pashoq të njerëzimit në Mekë: qindra mijë njerëz, të gjithë të frymëzuar nga idea e vetme që secili të ndjejë praninë e Qenies Hyjnore, të gjithë duke e përqëndruar mendjen në të Vetmen Qenie Supreme e Cila për momentin është objekti i tyre. Këtyre u shtohet dhe efekti i fuqishëm i unitetit të jashtëm i të gjithëve, të veshur njëllor me të njëjtët çift çarçafësh, duke thirrur në një gjuhë që kuptohet nga të gjithë: *lubbaika Allahumma lubbaika* – “Ja tek jemi, O Allah! Ja tek jemi ne praniën Tënde”. Sigurisht, nuk është se Zoti gjendet vetëm në Mekë e në asnjë vend tjetër, megjithatë ai grumbullim i jashtëzakonshëm njerëzish e ndjen praninë e Tij sikur Ai të ishte vërtetë mu në mes të tyre. E tillë është përvoja më e lartë shpirtore e shtegtarëve, përvoja jo e hermitit që mbyllet brenda në kuvlinë e tij, por përvoja e një mase të fuqishme njerëzish të mbledhur tok në një vend.

Pelegrinazhi ka dhe një ndikim të mrekullueshëm, si asnjë institucion tjetër në botë, në sheshimin e të gjitha dallimeve të racës, ngjyrës, kombësisë, rangut apo pasurisë. Jo vetëm që njerëz të të gjitha racave dhe të gjithë vendeve mbledhen së bashku si shërbëtorë të Zotit, por nuk ka asgjë që t'i dallojë të lartët nga të ultët. Është një mizëri e jashtëzakonshme qëniesh njerëzore, të gjithë të veshur njëllor, të gjithë duke lëvizur në të njëjtin drejtim, të gjithë vetëm me një fjalë në gojë. Në këtë mënyrë çdo muslimani i kërkohet që të kalojë një herë në jetë nëpër atë portë të ngushtë të barazisë që të çon drejt vllazërimit të gjërë. Të gjithë njerëzit janë të barabartë në lindje dhe në vdekje, por Pelegrinazhi është rasti i vetëm në të cilin ata mësohen si të jetojnë njëllor, si të veprojnë njëllor dhe

<sup>1</sup> Qabeja (Ka`ba) është ndërtesa e thjeshtë, katërkëndëshe e cila mbetur mbetur si faltore Hyjnore në Mekë që nga antikiteti shumë i largët. Duhet shënuar se muslimanët nuk i luten Qabesë, e cila është, në fakt, një përkujtimore e besimit në njëshmërinë e Zotit.

si të ndejnë njëlloj.

### **Akte të praktikueshme e kuptimplote të lutjes**

Kështu pra shihet se të gjitha këto rregulla morale islamike kanë për qëllim vetëm ngritjen morale të njeriut. Islami nuk parashtron asnjë institucion që mund të thuhet se është një adhurim i pakuptimtë i Zotit. Qëllimi e objekti i të gjitha rregullave morale që parashtron ai është pastrimi i zemrës me qëllim që duke u pastruar kështu, njeriu të mund të gëzojë komunikimin shpirtor me Qenien e Shenjtë, i Cili është Burimi kryesor i gjithë pastërtisë. Shihet gjithashtu se Islami paraqet formula asketike të përdorshme në jetën e përditshme të njeriut. Pesë faljet e përditshme kërkojnë që të sakrifkohet një pjesë e vogël e kohës së tij dhe, pa ndërhyrë në jetën e tij të përditshme, i japin mundësi të kuptojë Hyjnoren që është brënda tij. Agjërimi kërkon që të hiqet dorë nga ushqimi e lëngjet, por jo në mënyrë të atillë sa ai të mos jetë në gjendje të vazhdojë punën e tij të përditshme. Pelegrinazhi është një funksion të cilin njeriu e kryen përgjithësisht vetëm një herë në jetë, prandaj dhe, duke e drejtuar njeriun që të provojë përvojën më të lartë shpirtore, nuk ndërhyjnë në ndonjë shkallë të konsiderueshme në kursin e rregullt të jetës së tij.

## **10. DETYRAT E NJERIUT NDAJ NJERIUT**

Dega e dytë e rregullave morale islamike ka të bëjë me detyrat e njeriut ndaj njeriut, por duhet pasur parasysh se të dy llojet e rregullave morale janë të lidhur ngusht me njeri tjetrin. Ngritja morale e njeriut është tema madhore e Kuranit të Shenjtë dhe objekti kryesor që Islami e mban parasysh gjithnjë, dhe të gjithë parimet e tij morale kanë si synim të vetëm që ta ngrenë njerëzimin shkallë-shkallë deri në majat më të larta morale që mund të arrijë njeriu. “Personi që cënon të drejtën e vëllait të tij nuk është besimtar i Unitetit të Zotit”<sup>1</sup> Ky është një mësim që meriton të shkruhet me shkronja të arta.

### **Vllazërimi i Islamit**

Në radhë të parë, Islami zhdok çdo dallim që ka të bëjë me individin. “Sigurisht më fisniku midis jush në sytë e Zotit është ai që është më i drejti nga ju” është një shprehje që tingëllon si këmbanë vdekjeje për çfarëdo lloj superioriteti apo inferioriteti të bazuar në kasta të ngurra apo dallime sociale. Njerëzimi nuk është gjë tjetër veçse një familje sipas Kuranit të Shenjtë, i cili thotë:

“O njerëzim! Sigurisht Ne ju kemi krijuar nga një mashkull dhe një femër dhe kemi bërë për ju fise e familje që ju të mund të dalloni njeri-tjetrin. Sigurisht më fisniku midis jush në sytë e Zotit është ai i cili është më i drejti nga ju” (49:13).

Islami kështu hedh bazat e një vllazërimi të gjërë në të cilin gëzojnë të drejta të barabarta të gjithë burrat e gratë e çfarëdo fisi, kombi a kaste që mund të bëjnë pjesë, dhe cilido qoftë profesioni i tyre apo pozita e tyre në shoqëri, të pasurit dhe të varfërit, dhe në të cilin askush nuk mund të shkelë të drejtat e vëllait të tij. Në këtë vllazërim të gjithë antarët duhet ta trajtojnë njeri-tjetrin si antarët e të

<sup>1</sup> Një Thënie e Profetit të Shenjtë Muhamed

njejtës familje. Askush nuk duhet të privohet nga ndonjë e drejtë për shkak të racës, profesionit apo seksit të tij. Përveç se është e vetmja fe e cila vuri si detyrë çlirimin e skllevërve, si dhe e vetmja fe Themeluesi i të cilës dha shembullin personal të garantimit të lirisë për skllevërit, Islami gjithashtu kërkoi që një skllav të vishej me rrobat dhe të ushqehet me ushqimin e padronit të tij, dhe jo të trajtohej si person i ulët e i pavlerë. Dhe ky vllazërim i madh nuk mbeti vllazërim në teori, por u bë një forcë konkrete e gjallë nga shembulli fisnik i Profetit të Shenjtë dhe i pasuesve e shoqëruesve të tij të vyer. Rregulli i rreptë i vllazërimit parashtrohet në fjalët e mëposhtëme të Profetit të Shenjtë:

“Askush nga ju nuk është besimtar në Zotin përderisa secili të dojë për vëllain e tij atë që do për vete”.

### **Të drejtat e grave**

Asnjë libër tjetër fetar dhe asnjë reformator tjetër, qoftë fetar apo laik, nuk ka bërë as një të dhjetën e asaj që kanë bërë Kurani i Shenjtë apo Profeti i Shenjtë Muhamed për ngritjen e pozitës së grave. Si nga pikëpamja materiale ashtu dhe nga ajo shpirtrore Islami e njeh pozitën e gruas si të njejtë me atë të burrit. Favori më i madh që Zoti i ka dhuruar njerëzimit është dhurata e shfaqjes Hyjnore. Dhe ne gjejmë gra po ashtu si dhe burra që përmenden në Kuran se kanë provuar shfaqjen Hyjnore (shih, për shembull, 3:41 dhe 28:7). Kurani nuk bën dallime midis burrit dhe gruas në dhënien e shpërblimit Hyjnor për vepra të mira:

“Kushdo që bën mirë, qoftë mashkull apo femër, dhe është besimtar, do të hyjë në Kopësht (të qiellit)” (40:40; shih gjithashtu 3:194, 4:124, 16:97 dhe 33:35).

Pra, sipas mësimëve më të qarta të Kuranit, burrat dhe gratë mund të ngrihen në të njejtat lartësi të sferave morale e shpirtrore.

Edhe nga ana materiale, gruaja njihet si e barabartë me burrin. Ajo mund të fitojë para dhe të posedojë pronë pikërisht si burri: “Për burrat është përfitimi i asaj që fitojnë, dhe për gratë është përfitimi i asaj që fitojnë” (4:32). Ajo ka kontroll të plotë mbi pronën e saj dhe mund të bëjë me të ç’ të dojë. Në Arabi, në kohën e ardhjes së Profetit të Shenjtë, gruaja nuk kishte te drejta pronësie; ne fakt, ajo vetë ishte pjesë e trashëgimisë dhe vihej nën pronësi së bashku me prona të tjera. Kurani e nxorri atë nga kjo pozitë e ulët dhe e ngriti në pozitën e lirisë së përsosur për sa i përket të drejtave të saj të pronësisë dhe të drejtës së saj të trashëgimisë, një pozitë të cilën, bile dhe në kombet perëndimore moderne, ajo e ka arritur vetëm kohët e fundit pas një lufte të gjatë.

Për ngritjen e statusit moral të shoqërisë, Islami kërkoi që të dy sekset të sillen me modesti dhe të kultivojnë zakonet e mbajtjes së veshtrimit poshtë në praninë e njeri-tjetrit. Kur dalin përjashta, ose në raste të tjera kur ka përzjerje të sekseve, grave u kërkohet që të jenë të veshura siç duhet<sup>1</sup>, dhe të mos bëjnë reklamë të bukurisë me qëllim që të mos ngjallnin pasionet e seksit tjetër. Me këto masa paraprake gratë kanë liri të plotë të shkojnë ku të duan dhe të bëjnë çdo lloj pune.

Si bashkëshorte, një grua nuk humbet asnjë nga të drejtat që gëzon si antare individuale e

<sup>1</sup> Nuk ka urdhër të shkruar në Islam që kërkoi nga gratë që të mbajnë perçe. Në kohën e Profetit të Shenjtë, gratë shkonin të faleshin në xhami pa perçe, dhe e vetmja ndarje ishte se ato qëndronin në rrjeshta të veçantëprapa atyre të burrave. Në Pelegrinazh (Haxhillek) gratë bile e kishin të ndaluar të mbanin perçe (vello)meqenë se ajo ishte shenjë e rangut të lartë.

shoqërisë; as individualiteti i saj nuk shkrihet në atë të burrit të saj. Pozita e saj si bashkëshorte, sipas një Thënieje të Profetit të Shenjtë, është ajo e “një sundimtareje mbi shtëpinë e burrit të saj”. Edhe përsa i takon divorcit, i cili mund të bëhet i nevojshëm në qoftë se konsumohen të gjitha mjetet për të ndikuar në pajtimin midis burrit e gruas, Kurani i vë të dy palët në nivel të barazisë së plotë.

## Shteti

Profeti i Shenjtë Muhamed ishte jo vetëm Themelues i një feje por dhe Themelues i një shteti. Si feja që themeloi, edhe ideali i tij për shtetin ishte demokratik, por ishte një demokraci që bazohej në përgjegjësinë ndaj Zotit në radhë të parë. Përshkrimi i mëposhtëm i besimtarëve tregon se si shkriheshin këto dy ide të demokratizimit e purifikimit shpirtor të shtetit:

“Dhe ata që i përgjigjen thirrjes së Zotit të tyre dhe bëjnë lutje të vazhdueshme, dhe çeshtjet e të cilëve janë (vendosur) nga këshillimi midis tyre, dhe të cilët shpenzojnë për të ndihmuar të tjerët nga ato që Ne u kemi dhënë” (42:38).

Këto vargje u mësojnë muslimanëve parimin e demokracisë (“këshillimi midis tyre”) për drejtimin e çeshtjeve të shtetit, dhe në të njëjtën kohë i nxit ata të fitojnë cilësitë që e purifikojnë shpirtërisht njeriun dhe e tërheqin më afër nga Zoti. Pra Islami kërkon që autoriteti laik të ushtrohet me vetëdijen e plotë të përgjegjësisë ndaj Autoritetit më të Lartë Hyjnor, duke ia nënshtruar konsideratave morale forcën fizike të subjektit shtetror. Së këndejmi del se, sipas mësimëve islamike, qeveria duhet t’u besohet personave të cilët qëndrojnë në një plan moral e shpirtor shumë të lartë, ku kryetari i shtetit quhet njëkohësisht *amîr* (fjalë për fjalë ‘një që komandon’) dhe *imâm* (një person, morali i lartë i të cilit bëhet shembull për t’u ndjekur).

Parimet e qeverisë islamike u ilustruan në praktikë nga vetë Profeti i Shenjtë Muhamed si themelues e kryetar i shtetit musliman. Pas tij, katër pasardhësit e tij të parë njihen se kanë ndjekur udhën e tij për të dhënë shembullin e sundimit të vërtetë islamik, duke kombinuar demokracinë me shfaqje të një karakteri të lartë moral. Ky shtet islamik model ishte demokratik në kuptimin më të plotë të fjalës. Secili nga këta pasardhës (“Kalifë”) u zgjodh kryetar shteti me miratimin e të gjitha palëve. Kryetari ishte shërbëtor i shtetit, te cilit i paguhej një rrogë fikse nga thesari publik, si të gjithë shërbëtorëve të tjerë publikë. Ai nuk kishte asnjë privilegj të veçantë. Bile as vetë Profeti i Shenjtë nuk pretendonte për të drejta të tjera përveç atyre që kishin muslimanët e tjerë. Ishte një demokraci e çliruar nga të gjitha dallimet e trashëgimisë, rangut apo privilegjit. Të gjithë njerëzit, përfshirë sundimtarin, kishin të drejta dhe detyrime të barabarta dhe i nënshtroheshin të njëjtit ligj.

Nga ata, të cilëve u ishte besuar detyra e qeverisjes, kërkohej që të punonin për të mirën e popullit, të bënin jetë të thjeshtë e të ishin të gatshëm për t’u takuar me publikun, të ndihmonin materialisht ata që nuk ishin në gjendje të fitonin, si dhe të kishin po aq respekt për të drejtat e jo-muslimanëve sa dhe për ato të muslimanëve. Përgjegjësia e popullit ndaj shtetit është respektimi e bindja ndaj ligjeve të tij për sa kohë që ato nuk përfshijnë mosbindje ndaj Zotit dhe Lajmëtarit (Të Dërguarit) të Tij. Abu Bakr, pasardhësi i parë i Profetit të Shenjtë, tha në fjalimin e parë që mbajti:

“Më ndihmoni në qoftë se jam në rrugë të drejtë, dhe më korrigjoni në qoftë se jam në rrugë të gabuar. Të më bindeni për sa kohë që unë i bindem Zotit dhe Lajmëtarit (Të Dërguarit) të Tij. Në rast se unë shfaq



mosbindje ndaj tyre, atëherë unë nuk kam të drejtë të pres bindje nga ju.”

Kështu njerëzve u kërkohet që të “korrigjonin” autoritetet kur ishte e nevojshme. “Një nga veprat më të lavdërueshme”, theksonte Profeti i Shenjtë, “është t’i dërgosh një fjalë proteste një sundimtari të padrejtë”.

### Disa ilustrime të qeverisjes së vërtetë islamike

Kalifati i Umarit (vd. 644 C.E.), gjatë sundimit të të cilit posedimet muslimane përfshinin territorin e gjërë të Arabisë, Irakut, Iranit, Palestinës dhe Egjiptit, jep shembuj të shumtë të sundimit e demokracisë së vërtetë islamike në veprim. Gjatë kohës së tij kishte dy organizma konsultative: një asamble të përgjithshme në të cilën diskutoheshin çështje me rëndësi të veçantë kombëtare, dhe një komitet më të vogël për drejtimin e punëve të përditshme. Edhe jo-muslimanët ftoheshin për të marrë pjesë në këto konsulta. Si rregull, guvernatorët provincialë emëroheshin pas konsultimeve me popullatën e vendit. Në raste ankesash kundër guvernatorit nga ana e publikut, guvernatori hiqej në qoftë se dilte se ishte fajtor. Bëheshin betime nga zyrtarët e lartë të shtetit se ata nuk do të mbanin rroba të kushtueshme, se do ta mbanin derën gjithnjë hapur për nevojtarët, dhe se nuk do të mbanin kurrë roje te dera.

Çdo qytetar individ i shtetit të Islamit, qoftë musliman apo jo-musliman, gëzonte të drejtën për të dhënë opinionin e tij (saj) dhe ishte krejt i (e)lirë ta bënte një gjë të tillë. Një herë kur Umari po jepte një predikim, ishte pikërisht një grua që u ngrit dhe e kundërshtoi. Umeri, jo vetëm që nuk u zemërua për këtë, por e pranoi kritikën e saj dhe e pohoi gabimin e tij me fjalët: “Gratë e këtij qyteti i kuptojnë më mirë gjërat se Umari”. Pozita e kryetarit të shtetit ishte saktësisht si ajo e një qytetari të thjeshtë. Një herë, kur e hodhën në gjyq, Umari doli për të mbrojtur veten përpara gjyqit si çdo i pandehur tjetër. Kështu nën qeverisjen e Umarit parimi i demokracisë u avancua deri në një pikë në të cilën as bota moderne ende nuk ka arritur.<sup>1</sup>

### Xhahadi

Ekziston një koncept shumë i gabuar në lidhje me *xhahadin* (*xhahâd* fjalë për fjalë do të thotë *përpjekje* ose *luftim*), një nga detyrimet fetare të muslimanit. Në terminologjinë e Islamit, fjala *xhahâd* aplikohet si për veprimtaritë misionare të mirëfillta të një muslimani, ashtu dhe për mbrojtjen që i bën ai besimit të tij ne kuptimin fizik. Detyra e parë, detyra për t’i ftuar njerëzit në Islam, është një detyrë e përhershme që i ngarkohet të gjithë muslimanëve të të gjitha kohrave, kurse e dyta është një detyrë e cila del në rrethana të caktuara. Sipas Kuranit, një xhahad që ai e quan *xhahâd-an kabîr-an*, apo xhahadi i madh, duhet të zbatohet kundër jobesimtarëve me *anë të vetë Librit të Shenjtë* (shih 25:52). Prandaj, xhahadi më i madh i Islamit është jo me anën e shpatës por më anën e Kuranit, domethënë, me anën e përpjekjes misionare për ta çuar mesazhin e Islamit tek të gjithë kombet. Detyrimi në fe është i ndaluar me fjalë shumë të qarta: “Nuk ka detyrim në fe” (2:256). Dhe nuk ka asnjë rast në jetën e Profetit të Shenjtë që një individ t’i jetë kërkuar që të pranojë fenë islame nën

<sup>1</sup> Mund të shënohet se kjo shfaqje frymëzuese e idealeve të larta të Islamit erdhi jo në saje të futjes së një sistemi ligjesh formale (apo të “imponimit të sistemit islamik”, siç thuhet në sloganin politik modern), por për shkak të reformës së brendshme, morale që krijoi tek pasuesit e tij Profeti i Shenjtë Muhamed. – *Botuesi*.



tehun e shpatës.

Për sa i përket luftës e të luftuarit, kjo lejohet vetëm si masë mbrojtëse kundër atyre që zhveshin shpatën për të asgjësuar Islamin:

“Leje për të luftuar u jepet vetëm atyre kundër të cilëve bëhet luftë, sepse ata janë të keqtrajtuar” (22:39).

“Luftoni në rrugën e Zotit me ata që luftojnë me ju, dhe mos e kapërceni këtë kufi” (2:190)

Kjo nuk lë as dyshimin më të vogël se Islami nuk i lejon luftrat agresive, as luftën për ekspansion apo për prestigj. Ai e lejon luftën vetëm kur një shtet është sulmuar. Bile dhe atëhere, në qoftë se armiku ofron paqe, paqja duhet pranuar:

“Në qoftë se ata ofrojnë paqe, edhe ju duhet ta ofroni atë, dhe besoni në Zotin” (8:39).

Të gjitha betejat e zhvilluara nga Profeti i Shenjtë Muhamed dhe muslimanët e hershëm ishin thjesht mbrojtëse. Ai e pasuesit e tij pësuan persekutimet më të egra, kur Islami filloi të fitonte terren në Mekë. Edhe kur ata ikën nga shtëpitë e tyre dhe gjetën strehë në Medinën e largët, luftëtarët e fuqishëm të Mekës i sulmuan ata në vatrën e tyre të reja. Tri herë e sulmoi armiku Medinën me forca të mëdja për ta asgjësuar komunitetin musliman atje. Prandaj Kurani e lejoi luftën vetëm për të shpëtuar një komunitet të persekutuar nga shtypës të fuqishëm.

Profeti i Shenjtë ishte paqedashës nga natyra, dhe ai besonte se të bësh paqë me zemërgjërësi ishte shpesh një zgjidhje më e mirë për agresionin sesa asgjësimi i agresorit, sepse mund të sillte një ndryshim të vërtetë në zemrën e armikut. Prandaj ndodhi ajo që kur më në fund erdhi koha për t'i dënuar agresorët mizorë, të cilët ishin në mëshirën e Profetit të Shenjtë kur muslimanët dolën fitimtarë në Mekë, ai jo vetëm u dha atyre amnesti të përgjithshme por i lëshoi bile pa asnjë qortim. Ky akt zemërgjërësie ndaj armiqve më të betuar është i pashembullt në analet e botës.

### **Zakati dhe Bamirësia**

Do të vë në dukje edhe një veçori të vllazërimit të Islamit. Çdo fe e botës ka predikuar bamirësinë (ndihmën për nevojtarët), por vetëm në Islam ajo është bërë e detyrueshme dhe e kushtëzuar për të gjithë ata që e pranojnë besimin musliman. Këtu kemi një vllazërim në të cilin i pasuri nuk mund të hyjë në qoftë se nuk është i gatshëm për dhënë një pjesë të pasurisë së tij për antarët më të varfër të vllazërimit. Nuk ka dyshim se i pasuri nuk ndeshet këtu me vështirësi të pakapërcyeshme të testit ideal të devesë që kalon nëpër vrimën e gjilpërës, por ai i nënshtrohet një testi praktik, i cili jo vetëm e bën që të qëndrojë në një shkallë me vëllain e tij më të varfër, por dhe kërkon prej tij që të paguajë një taksë, të njohur si *Zakât*, një taksë e cila u vilet të pasurve për dobinë e të varfërve.

Secilit që ka pronë mbi një limit të caktuar i kërkohet që të ndajë një pjesë të caktuar të saj. Pjesa e veçuar për këtë qëllim duhet të mblidhet nga shteti musliman ose nga komuniteti musliman aty ku nuk ka shtet musliman, dhe objektet të cilave duhet t'u kushtohet numërohen në vargjet e mëposhtme:

“*Zakati* është vetëm për të varfërit dhe nevojtarët, dhe për ata që janë të punësuar për ta administruar atë, dhe për ata zemrat e të cilëve janë bërë gati për të përqaftuar të vërtetën, dhe për të liruar robërit, dhe për të

ndihmuar) ata që kanë borxhe, dhe për rrugën e Zotit, dhe për udhëtarin që ka mbetur në rrugë të madhe” (9:60).

Fjalët “në rrugën e Zotit” përfshijnë çdo qëllim bamirës. *Zakâti* ka diçka të veçantë se është njëherit edhe bamirësi, edhe taksë. Si bamirësi (ndhmë humanitare) është i detyrueshëm, por detyrimi është moral. Si taksë, sanksioni mbrapa tij është moral, jo forca fizike e shtetit. Prandaj *Zakâti* vepron jo vetëm si ndikim nivelues por dhe si mjet për zhvillimin e sentimenteve më të larta të njeriut – të ndjenjave të dashurise e simpatisë ndaj tjetrit. Duhet nënvizuar se, sipas Kuranit, një vepër bamirëse duhet bërë si një detyrë që një njeri i detyrohet tjetrit, në mënyrë që të mos krijojë idenë e superioritetit të atij që e jep apo të inferioritetit për atë që e merr (shih 2:262-264).

Përveç kontributeve materiale pagesa e të cilave është bërë e detyrueshme nga Kurani i Shenjtë dhe si diçka që duhet bërë patjetër si lutjet, bamirësia e përgjithshme është ngulitur me forcë të madhe në tërë Librin e Shenjtë. Ai jo vetëm vë theksin mbi vepra të tilla të mëdha bamirësie si emancipimi i skllëvërve (2:177, 90:13), të ushqyerit e të varfërve (69:34, etj.), kujdesi për jetimët (17:34, etj.), dhe kryerja e veprave të mira ndaj njerëzimit në përgjithësi, por i jep të njejtën vlerë dhe akteve të vogla të bamirësisë moskryerja e të cilave theksohet se është në kundërshtim me shpirtin e lutjes (107:4-7).

Në Thëniet e Profetit të Shenjtë bamirësisë i jepet domethënia më e plotë dhe më e gjërë. “Të heqësh nga rruga gjithshka që mund të shkaktojë dëm”, apo “t’i tregosh udhën dikujt”, apo bile t’i japësh ushqim familjes apo vetes – të gjitha janë vepra bamirësie. T’i bësh mirë krijesave pa gojë gjithashtu quhet bamirësi: “Kushdo që punon arën dhe zogjtë e kafshët hanë nga ajo, ajo është bamirësi”. Kurani i Shenjtë gjithashtu flet për zgjerimin e kufijve të bamirësisë jo vetëm tek të gjithë njerëzit përfshirë besimtarë e jobesimtarë (2:272), por dhe tek krijesat pa gojë (51:19).

Kontributi i bamirësisë duhet të jepet nga gjërat e mira, nga ato gjëra që një njeri i do për vete:

“O ju që besoni! Jepni për bamirësi nga gjërat e mira që fitoni . . . dhe mos synoni të jepni për bamirësi atë që është e keqe, me që ju vetë nuk do ta merrnit atë për vete” (2:267).

Dashuria për Zotin duhet të jetë motivi në të gjitha veprave bamirëse:

“(Njerëzit e moralshëm), nga dashuria për Atë, u japin ushqim të varfërve, jetimëve e robërve duke thënë: Ne po ju ushqejmë vetëm kënaqësinë e Zotit – ne nuk dëshirojmë nga ju as shpërblim as falënderime” (76:8,9)

## 11. SPEKTRI I MËSIMEVE MORALE

Kurani i Shenjtë nuk u konceptua për një popull apo për një epokë, dhe sipas gamës së mësimëve të tij morale ai është i gjërë sa vetë njerëzimi. Ai është një Libër i cili bëhet udhërrëfyes për të gjithë njerëzit në të gjitha kushtet e jetës, si për njeriun injorant e primitiv ashtu dhe për filozofin e urtë, si për njeriun e biznesit ashtu dhe për atë që jeton në vetmi, si për të pasurit ashtu dhe për të varfërit. Prandaj, ndërsa jep rregulla të ndryshme për jetën, ai kërkon nga individit që të ndjekë rregullat më të mira të cilat janë të zbatueshme për rrethanat në të cilat jeton (39:55). Në qoftë se përmban udhëzime nga njera anë të cilat janë llogaritur për të ngritur moralisht njerëzit e zhytur në shkallët

më të ulëta të qytetërimit dhe për t'ua mësuar atyre mënyrat elementare të sjelljes në shoqëri, ai gjithashtu sjell rregulla që i drejtojnë njerëzit për të arritur shkallët më të larta të përparimit moral e shpirtor. Mësimet e larta morale ideale janë padyshim të nevojshme për përparimin e njeriut, por vetëm ata të cilët janë në gjendje t'i kuptojnë ato ideale do të jenë në gjendje të përfitojnë prej tyre. Por në këtë klasë nuk bëjnë pjesë masat e gjëra në një komb apo komunitet, sado i lartë të jetë standarti i tij i qytetërimit. Si rrjedhojë, Kurani përmban rregulla udhëzuese për të gjitha fazat nëpër të cilat njeriu ka qenë i detyruar të kalojë në marshimin e tij përpara që nga kushtet e primitivizmit në ato të njeriut me zhvillim të lartë shpirtor. Ato përfshijnë të gjitha degët e veprimit të njerëzore dhe kërkojnë zhvillimin e të gjitha aftësive mendore të njeriut.

Islami kërkon shfaqjen e çdo cilësie që përmban në vetvete njeriu, dhe bën vetëm një kufizim, domethënë, që ajo të shfaqet në rastin e duhur. Ai kërkon nga njeriu që të tregojë si butësi ashtu dhe guxim, por secila në rastin e duhur. Ai i mëson njerëzit që të falin, por në të njëjtën kohë ai kërkon që kur natyra e keqbërjes kërkon ndëshkim, duhet të jepet ndëshkim në përputhje me shkallën e krimit. Ai thotë: “Falni kur e shikoni se falja do të sillte rezultate pozitive”. Përsëri, ai i mëson njerëzit të tregojnë veti të larta morale në rrethanat më të disfavorëshme, të jenë të ndershëm bile dhe kur ndershmëria ka të ngjarë ta fusë njeriun në situata të ngatërruara, të thonë të vërtetën edhe kur pohimi i së vërtetës është kundër atyre që janë më të afërt e më të dashur për ne, të tregojnë keqardhje bile dhe duke sakrifikuar interesat e veta, të jenë të durueshëm edhe nën vuajtjet më të rënda, të jenë të mirë bile dhe me ata që u kanë bërë keq. Në të njëjtën kohë ai na meson që të ndjekim rrugën e mesme; ai i mëson njerëzit të ushtrojnë cilësitë fisnike të cilat janë vendosur në natyrën e tyre nga Zoti kur janë duke u marrë me punët e tyre. Ai nuk ngulmon që njeriu të shkëputet nga lidhjet e tij materiale; ai kërkon që ata t'i shërbejnë Zotit, por jo si murgjit; ai i porosit ata që ta shpenzojnë pasurinë e tyre, por jo në mënyrë të atillë sa të mbeteni “në pikë të hallit e pa asnjë grosh”; ai i meson ata të jenë kokëulur por jo duke humbur vet-respektin; ai i këshillon që të falin, por jo në mënyrë të atillë sa t'u japin zemër fajtorëve; ai i lejon të ushtrojnë të gjitha të drejtat e tyre, por jo deri aty sa të çenojnë të tjerët; dhe e fundit fare, ai kërkon nga ata që ta predikojnë fenë e tyre, por jo duke denigruar të tjerat.

=====